

Shyqyri Fejzo

# Vërejtje me shënim në ...portofol

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

814-32-2

FSP



tregime  
humoristike

*84-32-7*

*F 3P.*

Shyqyri Fejzo



*2018*

Vërejtje  
me shënim  
në .... portofol

tregime  
humoristike

**RRËNJE TË FORTA**

## **RRËNJE TË FORTA**

and the first stage of the process of the formation of the new society at  
the moment of the revolution. The Bolsheviks were not without  
dangerous traits in this connection, and they did not fully understand  
the situation. They did not fully understand the importance of the mass of  
the people in the struggle for the realization of their demands.

Me t'u kthyer nga qyteti, fillova të mos e ndieja veten mirë. Kam gjuar gjithnjë shëndet, të plotë, bile dhe tanë si molla jam, por atëherë nisa të shqetësohesh, sidomos kur shkoja të merrja qumështin, në stallat e tufave kolektive. Besomëni! Më ziente, koka, sa dilja nga shtëpia e gjersa sosja atje, me enët e qumështit në dorë. Po kjo sikur s'qenkesh mjart. S'më linin rehat as të tjérët. Vetëm dy ditët e para s'më trazuan, se demek i kishte marrë malli pér mua, se paskësha qëndruar gjatë andej nga kasabaja. Po pastaj, thua ti? Lëre se ç'vajti! Më vunë pérpara dhe nuk dija se kù do të përfundoja. Si me terezi i lëshonin ato të shkreta fjalë, që unë e merrja vesh sé cilin thumbonin. Ama, kot nuk thonë nganjëherë, se në këtë botë lahen të gjitha. Ç'ishte e vërteta, borxh të gjithëve ua kisha bërë, kujt më shumë e kujt më

pak, po se do vinte dita që të ma punonin ashtu, kurrë nuk ma kishte prerë mendja. Dhe shkak u bë-në bagëtia, dreqi i mori, se, po të mos kishin qenë ato, nuk do të më kishin rënë një barrë telashe, në kohën kur u thinja.

Të themi atë që është, unë që në krye të herës i kam pasur shumë qejf bagëtitë. Pse ta fsheh! Me to unë jo vetëm e kaloja mirë, po edhe kur dola në pension, po të mos kisha delet, do të kisha luajtur nga fiqiri. Ditën i kullosja mezhdave, anës arave e ledheve. Zarar kurrë nuk bëja, ndaj dhe me njeri kurrë nuk u përfola. Kur doli në pension dhe shoku im i fëmijërisë, Bantushi, edhe më mirë u bë. Ngado të shkoje, ne të dy do të na shikoje duke kullotur dhentë. Ore, asnje ditë nuk u ndamë. Mirëpo, kjo pranverë, gjynah mos qoftë, sikur na mori mësysh. Terezinë na e prishi një mbledhje që u bë në fshatin tonë. Aty u vendos që bagëtinë e oborrit personal ta bëashkonim në një tufë kolektive. Mendje-mendje dëgjoje atë ditë. Njëri thoshte se do të shpëtonim vete e me kalamaj, një tjetër ia priste se nuk kishte ku të vente më bukur, e më the të thashë... Edhe unë dakord qeshë, me të dyja duart. Pse, çfarë isha, të bëjë ndryshe? Gjithnjë i pari kam qenë. Po pastaj si do ta ruaja nderin e djalit, që ishte kooperativist i dalluar? Fjalën e dhashë, por thellë në zemër se si më vinte pér ato të uruara bagëti. Çuditesha edhe vete. Unë isha ai që dorëzova një pendë qe, një lopë dhe 30 krerë dhen, kur u ngrit kooperativa dhe tani më ardhkësh keq se do të futja në tufën e kolektivit dy gika gjë! Dhashë e mora ta gjeja se nga më vinte kjo, por s'ia dola mbanë. I rashë pastaj shkurt: «Po u plake, t'u shtoka më shumë meraku».



Llafosa edhe me djalin një natë, por ai seç më përrallisi për një mikrob të pronës private. Të kish qenë ky lanet, që ma bënte mendjen taravok!?

— Rri, more! Rri, të them, se nuk merr vesh nga këto punë ti! — i thashë djalit. — Unë u bëra 65 vjeç dhe nuk di ç'janë sëmundjet në trupin tim. Po ta kisha atë mikrobin që thua, do të ta kisha ngjitur ty e pjellës sate.

Ai qerrata qeshi mirë e mirë, po kur e pashë si vëngër, ma ktheu:

— Nuk duket ai, or baba, jo!

Turli mendjesh më vinin, kur rrija duke kullo-tur dhentë. Nganjëherë më mbante shpresat se ajo që kish nisur, nuk do të bitiste. Te ne hante pula gurë. Edhe kooperativa po hiqte mundim me të le-shtat e saj, jo t'i shtonte dhe dy hise!

Në mbledhjen tjeter që u bë në fshat për këtë punë, dy bashkëfshatarët e mi folën si të kishin qenë në një mendje me mua. Thanë që, demek, ne nuk kemi zahire dhe ahure për tufa të mëdha. Mirëpo Banushi ia priti aty për aty:

— Në ato toka ku kanë kullotur deri tani, atje do të kullosin prapë. Kurse ahuret, t'i bëjmë vetë, se nuk i kemi duart të thara, de!

«Hajde të sqaruar, hajde, që bëka shoku im!» thashë i heshtur.

Këto ndodhira nuk po më hiqeshin nga mendja, kudo që isha. Bari rritej dhe bagëtitë e mia shto qumështin, po edhe stallat e tufave kolektive nuk po mbeteshin pas. Brigada foragjere nuk po gjente vend të fuste sa më shumë ushqime të thata pët bagëtitë. Ashtu si po merrnin udhë punët, e pashë se edhe tufa ime i kishte ditët të numëruara. Ndaj edhe men-

dimet më shtoheshin përditë. Nga të gjitha llojet më vinin në kokë. Erdha e u bëra si i shushatur. Më dukej se çdo ditë kisha pirë esëll një kile raki mireje.

«Po sikur të mos i çoj fare dhentë e mia në tu-fë? — më vinte një mendje. Jo, jo! Kjo nuk bëhej. — Po fjala që ke dhënë? — ia priste mendja tjetër. — Apo nuk je dhe burrë me thinja!» U mendova si shumë për atë hall që më kishte mbirë në pleqëri. Një ditë vendosa si do të bëja. Do t'i shisja, se të miat i kisha, në fund të fundit! M'u duk se u lirova. Shpejt e shpejt i them Latifit, tim biri, se vëllai i tij atje në qytet na paskësh një hall të madh dhe unë do t'i dërgoja ca para. Kësisoj, vura tufën e dhënve përpara që me sabah dhe sosa në pazar. Si e mylla birinxhi pazarin, zura një taksi, u kapardisa mirë e mirë në të dhe vajta drejt e te djali në shtëpi. Të gjithë u gëzuan sa më panë, se kisha goxha kohë që nuk qeshë dukur andej. Kur ua zura fillesh se kë-saj, here do të rrija si gjatë, më ngjau se u çuditën pak, po nuk e shfaqën. Dhe për të çuditur ishte vërtet. Njerëzit në verë vinin në fshat për hava nga qyteti, kurse unë... Për punën e pazarit dhe të bagëtive nuk e hapa gojën. Mirëpo, këto punë, or xhan i vëllait, s'i mbushin dyzet ditë e dalin mbi dhe. Ma do mëndja që ai qerrata çun në ca pikë mua më ka ngjare. Një ditë, duke pirë kafe, si larg e larg më tha:

— Nuk më ndihmove me ca para për atë hallin e madh që pata, o baba.

« Ehë! — thashë me vete. — Kjo punë paska marrë erë!» Kur e pashë se lakrorit i ishin hequr petët, i tregova një për një tim biri se si kisha bërë.

— E kam marrë vesh me kohë, — ma ktheu ai, kur mbarova së rrëfyeri. — Nuk të kam rënë në sy, se kisha frikë mos mërziteshe dhe ikje fare. M'i tha të gjitha Banushi mua, kur e takova një ditë këtu në qytet.

— Pse nuk e ftove të vinte dhe këndej e të bënim ca muhabet, mor lanet? — ia prita, po mendja më fluturonte gjetkë: «Si, më paskësh kallëzuar, firauni!»

Ai s'm'u përgjigj e vazhdoi:

— Ishte bërë stallier i tufës kolektive. «Po nuk ndërroi mendje Qerimi, — më tha, — mos të piqemi më bashkë!»

Mua nisën të më kullonin djersë të ftohta.

«Kur e dika Banushi meselenë time, s'do të ketë mbetur njeri pa e marrë vesh në fshat,» blyav me mend. Kjo ishte ç'ishte. Ç'më ishte dashur ai avaz në pleqëri! Kush i mbante tanë ata të fshatit, pa le të tjerat! E vendosa të blija dhentë dhe të khehesha mënjenjëherë. Sa më shumë të vonohesha, aq më keq do të ishte për mua. Në kurrizin tim do të binin të gjitha kopaçet.

— Vetëm katër krerë merr, se të tjerat i ka blerë Latifi! — më tha çuni. Dhe unë ashtu bëra. Bleva dhentë dhe u nisa për në fshat. Doemos, u gjuan nusja, djali dhe fëmijët; u qeshë kthyer pas aq kohë larguar. Po edhe mua malli ama më kishte këputur për të gjithë. Të nesërmen në mëngjes, pasi u bëra edhe nga një shenjë në vesh me thikë dheneve të blera, i nisa për në tufën kolektive. Të parin, në rrugë, për dreq, poqa Banushin. Nuk priti më por, sa më pa, e zbrazi të shkretën:

— Në merá i pate për verë ato dhen, ore Qerim?

Nuk ke frikë se të ftohen dhe t'i zë purtha, po i solle në tufën e përbashkët? ... Bah, bah! Ç'paske qenë! Po si t'u mbush mendja, a derëbardhë? — vazhdoi pa të keq ai.

Ditën e parë dhe të dytë vetëm Banushi u ndje, kurse të tjerët dëgjonin dhe nuk bënин zë. Mirëpo, si erdhën punët më vonë, e kuptova se ma paskëshin bërë kastile. Kishin ndarë ditën e tretë për t'u hedhur në «aksion».

— A të kanë qumësht dhentë, o xha Qerim? — thërriste Shanikoja.

— Të gjitha dhentë jabanxhie t'i zuri gjaku, o i uruar, që u preve veshët? — ia priste një tjetër.

— Xha Qerimin mos e ngacmoni, se ai i bleu dellet dhe i solli në tufë. Kjo tregon se e ka kuptuar gabimin, — hidhej Brahoja, sekretari.

— Mirë, o, mirë, po i ka sakatuar nga veshët, që t'i njoħe 'si mallin' e tij.

— Shenjat ne i hoqëm me 'kohë dhe njëherë e mirë, e ky kerkón tē na i kthejë prapë!

Brahoja po nxirrte paketën. Më dha' një cigare dhe, si e ndezëm, po më shikonte drejt e në sy, demek ishin tē vërteta ato fjalë? Unë i ula sytë. Ndjeva dorën e sekretarit në qafë. Kjo gjë sikur më ngrohu' ca.

Vërtét paskësh qenë mikrob i keq e më rrënjjë tē forta ai i 'pronës private!

## NE FSHAT, PER «PUSHIME»

Mora lejen e zakonshme dhe vendosa te shkoja ne llixha. Sa herë që kthehesha prej andej, nuk më therte më çapoku i majtë. Ditën kur do te nisesha, më erdhë ne shtëpi Estrefi dhe më turbulloi mendjen:

— Aman, te keqen! Ç'i do llixhat! — më tha. — Më mirë vemi ne fshat mysafirë! Mos ma prish, më qafsh, se do te kënaqesh, ke per te parë! Kur qeshë tre vjet te shkuar, vend nuç gjenin ku te më vinin. Raki e mish gjer ne gju, ngado që vajta!

— Nuk vij, jo, — ia ktheva. — Nga ajo anë, që thua ti, as që më bëhet vonë. Kam qenë para teje ne fshat unë, xurxull më nxorën një herë. Te më shtrydhje, raki nxirrja. Po ai m'u qep mua dhe, bëri ç'bëri, aty nga dreka më shkuli nga vendi. Tari-koja, ime shoqe, më kot u përpoq te më pengonte. Edhe asaj i vajti mundimi huq.

— Sytë nxirr me gjithë të, — më tha, — po vetëm vishu trashë, se më ftoshesh dhe s'ta kam ngenë tani në pleqëri!

\* \* \*

Nisjen e patëm të mbarë. Për makinë nuk pritëm as një gjysmë ore. Afër mbrëmjes arritëm më fshat. Unë doja të rrnim atë natë te Rrapoja, po Estrefi nuk qe në një mendje.

— Sonte do të vemi nga Myslimi, se i mbetet hatëri. Është më i madh, pa ka dhe rakinë, që...

Nuk ia prisha.

— Mirë, — i thashë. Ec e ec, trokitëm te shtëpia e Myslimit. Na priti e ëma plakë. Të dy hapëm sytë për Myslimin, për të shoqen, apo për të birin, po gjékundi nuk i pamë. Rri e rri, më fshat ra errësira, e megjithatë asnjë nga ata nuk po dukej. Plaka, si vuri re që ne po mërziteshim, na tha se Myslimi, nusja e nipi kishin radhën të punonin në makinën shirëse gjer në orën 6 të mëngjesit.

— Hajde, Myslimi, hajde! Paske ndryshuar shumë! As nata nuk të mbajtka! — shfryu Estrefi. Ç'të bënim! Hëngrëm ç'hëngrëm dhe ramë të flinim. E pashë se shokut tim po i vinte plasje, po s'kishte kujt t'i ankohej.

— Për drekë do të shkojmë nga Rrapushi yt, se te Myslimi «i ramë qarit», — më tha kur dolëm nga shtëpia.

— Atje, atje të vemi, dhe ke për të parë se nuk e bën oxhakun buxhak ai! — iu përgjigja. Ik e ik, këmbët n'a quan nga dyqani i fshatit. Cigaret më

ishin soşur. Mendova tē blija një paketë. Kaluam qoshen e murit dhe u ndodhëm ballë pér ballë me derën e dyqanit. Ajo ishte e kyçur. Nën tabelën e orarit ishte një copë letër.

— Do tē jetë me leje shitësi, — foli Estrefi. — S'dinë kur e marrin atë tē flamosur leje! — vazhdoi.

— Po ja, si ne tē dy! — ia prita.

Kur u afruam më shumë, ai lexoi si nëpër hundë:

«Jam në lëmë, tek ara e Rrushkullit. Dyqani hapet në ora 18.00.

Tofikuuu» —

e zgjati «u-në» Estref «efendiu».

— E more vesh tani se ku na qenka? Këtyre sivjet ua lumsha, or vëlla! E paskan zënë mbarë! — gufova i téri. — Ja edhe klubi e paska një letër në derë!

— Më duket, s'kemi ardhur në kohë tē mirë, — m'u përgjigj shoku.

— E vështrova në sy. Ai e kishte hapur gojën si tē kishte net tē tëra pa gjumë. Ishim tē kapitur. Pasi bëmë edhe ca hapa, si tē qemë në një mendje, u ulëm te një stol dërrase pranë një shelgu lotues. Ishte koha pér ta pirë një cigare, ndaj nuk vonuam ta dridhnik sipas qejfit nga qeska e Estrefit. Befas vura re se ai po më shikonte i habitur. «Do ta ketë ndonjë ky! — mendova. — Po tē shohim se ku do ta nxjerrë kokën!»

— Phë! Qudi më vjen me ty! — më tha. — U nise me mërzitje, po ma shite mua tani! Më duke sh téré qejf!

Nuk arrita t'i jepja përgjigje, se prapa nesh u dëgjuat një këngë partizane nga zëra fëmijësh. Ata

vinin nga rruga kryesore e shkonin në drejtim të arave të kooperativës. Dalluam prapa tyre një të rritur me kostum doku bezhë, që mbante në kokë një kashtore të madhe si ato të meksikanëve. Kur na u afrua edhe më, e njohëm menjëherë. Ishte Rrapoja! Në vahtit të tij kurrë nuk qe marrë me fëmi-jë, ndaj po çuditeshim. Sa për në luftë, po, s'kishte ç'ti thoshe! Ishte i gishtit. Të tillë e njihni. Më vone u bë bujk i zoti. Ç'i shihnin sytë, ia bënин duarjt. Po t'i mbrehte qetë, zerzelja i zinte. Po të kapte kosën e ngryste, po nuk e gdhinte livadhin! Mjaltë e kishte fjalën. Ç'qe katandisur tani!? Udhëheqës i pionierëve! «Jo, jo; kjo nuk është e mundur!» tha-shë me vete dhe nisa të férkoja sytë me të dyja duart.

— E-e-e! Nuk po më njihni, a? — na thirri ai. Sec i tha si në vesh, një, djali më të rritur e u nis drejt nesh.

— Ti, qenke, vërtet, o Rrapo!? — tha Estrefi i çuditur më shumë se unë. U përqafuam me të, gjithë mallëngjim, si shokë të vjetër.

— Nuk e besoja se do të vinit në këtë kohë. Ta-hi dola në pension, po nuk më rrighet. Kam marrë një kompani pionierësh e po mbledh kallëza gruri nëpër ara. Flori e kemi grurin sivjet... Tani, më presin fëmijët!... Bëni ç'bëni, dhe për darkë hajdeni nga unë! — foli duke u larguar.

— He-he-he-eee! — më vrau veshët e qeshura e Estrefit, kur Rrapoja e kishte kaluar kthesën. Unë

e dija se ç'do të thoshte ai me këtë të qeshur, por kas-tile nuk u ndjeva. Më në fund atij nuk iu ndenj.

— Ama edhe Rrapoja yt të pritur që na bëri! — më tha. — Të paktën tek ai Myslimi im hymë bren-dat.

Nga ato fjalë desh më hipën dhe desh iu zbraza, po e mbajta veten. U dëgjua zhurma e një makine që po afrohej. Ajo dha ballë te kthesa dhe mori drejtimin tonë. Një re pluhuri e dendur e ndiqte nga prapa. Shoku im mendohej. Nuk e dija se çfarë bluan-te në kokë; mbasë ishte turbulluar se ende s'kish-te vënë raki në buzë.

— Po u kthyё në qytet ajo, ia hipim? — më pyeti. — Për besë, këtu nuk ke se me cilim të llafolesh! Këtyre u qenka bërë koka fushatë të gjithëve! — përfundoi duke thithur i vrënjtur duhanin.

— Tamam, — ia prita. — Nuk ke ku pi një go-të! Nuk paskemi këmbë të mbarë siyjet!

Makina tani na ishte afruar. Ajo ishtë e ndërmarrjes së grumbullimit.

— Solla aksionistë dhe do të ngarkoj grurë, — na tha shofer Arifi, si frenoi e duke këmbyer me ne nga një cigare. — Po ju më autobusin e orës gjashtë erdhët?

— Jo, me atë të orës dy, — ia ktheu Estrefi, duke i trëguar këmbët. — Jemi më leje, jo në aksion. Po pate mundësi, na merr deri...

Unë ndërhyra e ia ndërpresa fjalën shokut. I urova shoferit rrugë të mbarë.

— Ç'na bëre, mor i mallkuar, ç'na bëre! Për një orë arrinim në qytet! Ku të katranosemi tanë! — ulëriu Estrefi.

Dasha të teshtija fort, po nuk mundesha.



— Këtu e shkele, — i thashë. — Ne kemi ardhur për pushime dhe jo për t'u kthyer pa e lagur fare!

Kur e pashë se u zymtësua më shumë, vazhdo-va:

— Hajde, hajde, se për drekë dò të shkojmë nga Afëzi. Ai është baballëk shtëpie e nuk lëviz kollaj përjashta!

— Mirë, or, mirë, po vij, po kam frikë se mos ka ikur edhe ai me ndonjë kompani pionierësh! — tha si me përtim Estrefi.

Nuk e bëmë të gjatë. Mërom rrugën për te shtë-pia e Afëzit. Si kaluam luginen e vogël përa bllo-kut të mollëve, dolëm në arrën e madhe. Atje na u shfaq një pamje e re. Ca qerre mbartnin duaj gru-ri. Në fund të arës dukej një makinë shirëse bashkë me zetorin, ndërsa njerëzit ishin të gjithë në lëvizje. Kush lidhte thasët e mbushur me grurë, të tjëre shtynin kashtë me sfurqë dhe e bënin kavaleta. Si pa-dashur këmbët na afruan të makina. Aty prapë nuk po u zinim besë syve: Afëzi, më thinja në kokë, ngrinte duaj me sfurk, si të ishte djalë.

— Bah! Bah! Dhe kjo na u desh! — mërmëriti Estrefi. Afëzi na pa, la sfurkun dhe na u turr.


— Sa mirë bëtë që erdhët! — na tha. — Mua më thanë që erdhën dy makina me aksionistë për të na ndihmuar në fushatë, po nuk ma merrte mendja se do të vinit edhe ju. Ah! Nuk bie poshtë kocka e vjetër, or, jo! Sot do të punojmë të tre në makinën shirëse, se na kanë ikur nja dy të reja në rreth përmbledhje. Do t'i zëvendësojmë, hë? — Pa e zgjatur dhe pa marrë përgjigje nga ne, na futi të dyve kra-hët dhe na afroi te makina...

— Kemi pasur shumë punë këtë sene. Grurin e

kemi det, — vazhdonte të fliste Afëzi. Këto fjalë shokun tim po e tërbonin.

— Mos u mërzit, a derëbardhë! — i thashë, kur u largua pak Afëzi. — Këtu edhe dhjetë ditë grurë ka dhe u mbarohet.

— Mirë e ke ti, mirë, fol tanë! Fajin e kam vetë, që të futa mizat e të prura në fshat. Kështu e duam ti dhe unë, — m'u përgjigj Estrefi, tek filloj të hidhëtë duajt me cfurk lart në makinën shirëse.



2 — 134

## **«ME MEND NË KOKË, XHAN I VËLLAIT!»**

Të them të vërtetët, zyrtarët deri para pak kohësh i kam shikuar me sy jo aq të mirë. Më dukej se e hanin bukën qyl. Ja që kështu më ishte tiposur. Ka të ngjarë t'i kem marrë inat, se vëreja që disa nga ata e mbushnin kupën. Kur do ti? Një ditë më thonë dhe mua të bëhem furnitor i kooperativës, domethënë të isha kryesish njeri me kalem në dorë. Ta merr mendja, edhe me zyrë. Kuptohet që s'pranova. Pa-pa-pa! Ç'qe ajo fjalë! Unë të ikja nga prodhimi? Pse, çfarë isha? Nga ata që ndryshe thonë e ndryshe bëjnë? Mirëpo, duke ngulur këmbë si mushka, e di ti, or vëlla, se gjeta belanë.

— Do të shkosh në punën e re, se nuk bën! Po nuk shkove, e shikojmë, do të punosh dot gjetkë? — po më shtrëngonte vidhat kryetari i kooperativës. Ai një fjalë, unë tri. Kur gjakrat na ishin nxehur sa nuk kishte ku të vente më, e mori fjalën sekreta-

ri i partisë, Shaqoja që deri atëherë kishte ndenjur pa folur.

— Mos u nxeh, or kryetar, mos u nxeh aq! Nuk bëhen kështu punët! — tha kështu dhe më hodhi dorën në qafë. Desha të luaja vendit e t'i shpëtoja, po nga vështrimi i tij i përzemërt këmbët nuk m'u bindën.


— Dhe ti merre më shtruar! — m'u kthye mua duke më parë në bebe të syrit. — Sot për ne detyra e furnitorit është front i vështirë.

«Tani e hëngra, — mendova. — Po re në zdrugun e këtij ustai, di vetë si të zdrugon ky!» Pra, nuk kisha nga t'ia mbajë. U bëra që u bëra furnitor.

Kur isha në brigadë, kjo detyrë më ishte dukur më e lehtë, po tani që kam mbi gjashtë muaj që po ia shoh bulmetin, e kuptoj se paskam qenë fyl. Tani dhe unë i jap të drejtë xha Trifonit, që thotë sa herë: «Mos i pesho gjérat me kandarin tënd!». Punët nganjëherë vijnë kaq të ngatërruara, sa gjithë brigadën të futësh në tò, nuk i shkoqit dot. Kur mbetem keq, i them vetes: «Të keqen e kazmës! Këtu qenka ç'qenka!»

Dhe, or vëlla, është afër mendsh. Një brigadë do pleh kimik, se i është sosur ai që ka marrë më parë. Një stallier ankohet për kripën e gurit, se nuk ia hanë me qejf viçat, tani e tutje do kripë deti. Furrëxhiut i janë çarë shtatë tepsi të rrumbullakëta e pesë katrose. Përgjegjësit të vatrës së kulturës i është shpuar lëkura e gajdes... e më the të thashë që nuk kanë të sosur.

— Po ata në punën e tyre, ti në tënden! — më tha një shok, që mendonte si unë në fillim.



— Jo, or i dashur, jo! — ia ktheva. — Të gjitha këto lidhen me punën time si furnitor!

Ditët e para më mbajtën si atë nusen e re në shtëpinë e dhëndrit, po më vonë ma thanë troc se duhej të eçja me këmbët e mia. Emblohdha kallaballë-kun dhe, ke parë ti, vura rregull. Kritikat sikur filluan e ranë, dhe aty — këtu më hidhnin ndonjë lëvdatë. Qejfi më bëhej shumë, të them të drejtën, se, në fund të fundit, më shikonin me sy të mirë, jo ashtu siç mendoja unë përpara për zyrtarët. Por, terezinë më prishën furnizimet jashtë kooperativës. Disa ndërmarrje nuk na sillnin në kohë me mjetet e tyre peshat e rënda sipas kontratave. Kur më mbe-ti sharra në gozhdë, dhashë e mora të gjeja ndonjë rrugëdalje, po nuk qe e thënë. Sesi m'u dha një ditë të shikoja kontratat. Dhe ato e paskëshin rrugë-zgjidhjen brenda! Për çdo mosmarrëveshje të tregoinin arbitrazhin... Kështu, pa e zgjatur, përgatita materialin. Një mëngjes më shi ia çova kryetarit në zyrë për firmë e vulë. Ai më pa mirë e mirë, e mori dhe u ul ta lëxonte. Kur unë prisja me ankth lëvdatat e tij për iniciativën që po merrja për t'i shkundur furnitorët e ndërmarrjeve të tjera tanë në fund të vitit, ai ma preu shkurt:

— Nga ata të arbitražhit kam parë keq, o Laze, se nuk ta zgjatin, po vetëm vërejtje me shënim në portofol dinë të të jepin. Bëjmë si të bëjmë me makinat e mjetet tonë, për kokën tënde, dhe e myllim këtë muhabet, që të mos na marrin zët, dreqi e mori!

Dola nga kryetari e u drejtova te shoferët e kooperativës, Ahmeti e Idrizi, demek që t'i pyesja, në ç hanim dot atë punë që na kishte mbetur.

— Sà të na kesh ne, ti mos u bëj merak, o Laze!  
— më thanë e më rrahën gjoksin, kur ua shtrova problemin këmbëkryq e ashiqare. Kjo gjë çoku më ngrohu një çikë, pas atij inati që kisha marrë me bazën e furnizimit dhe furnitorët e tjerë. Pas ca më thirri shefi i llogarisë dhe më tha:

— Shko në magazinë dhe sqarohu me Bejazen për 1 kile raki; 5 kile arra dhe 8 kile mollë, o Laze!

— Pse, si është puna? — e pyeta i habitur.

— Shko, shko njëherë andej, pa pastaj mua këtu më ke dhe të sqaroj kur të duash! Ti dhe shoferët i morët ato, po se ku i çuat, nuk më duhet shumë. Tani, ose i gjeni dhe ia ktheni magazinieres, ose paguani «tring» paratë!

Kërceva përpjetë, po shpejt e mblojha veten. E dijë së shefi ynë të thante në laps e se me atë nuk bëhej shaka, ndaj kërkova për sqarim një nga shoferët. Po kjo!? Pa marrë gjë prej gjëje, të paguaja paratë!?

— Oho! Pse, tani e more vesh ti?! — më tha shofer Idrizi duke qeshur. Ne kështu i kemi mbajtur makinat gjallë se, po nuk e «lëve rrötën», nuk gjen gjë andej poshtë.

Mua më hipën kacabunjtë, kurse ai as që u turbullua fare. Si e pa që unë thartova turinjtë, vazhdoi:

— Mos u mërzit, a derëbardhë! Mos u mërzit, se dhe kësaj here i paguajmë ne, pa më tutje, po të prishen makinat, kaq ta bësh dhëmbin ti, ne nuk çapim më gjëkundi.

Kaluan disa ditë. Pa erdhi koha që të dyja makinat pësuan defekt. Shoferët iu qanë kryetarit të

kooperativës se u mungonin ca mbrokulla, pa të cilat nuk bënин dot çap.

— Të shkonin e t'i merrni dhe pasnesër të jeni gati për punë, — u bërtiti ai. — Fushatën paskeni ruajtur ju për defekte?

— Le të shkojë Lezja, furnitori, se nuk e mbytën hallet! — iu përgjigj aty për aty Ahmeti. E kryetari sikur aq deshi. Më thirri mua dhe më nisi fill e në qytet, pasi më porositi që ta bëja punën sa më të qëruar.

Në dyqanin e pjesëve të këmbimit më pritën si jo më mirë. Shitësi nuk më kishte parë herë tjetër. Më mati me sy nga koka te këmbët. Pastaj m'i nguli sytë mbi çizmet e ngarkuara me baltë të kuqe, u bind nga isha dhe e shtroi një çikë mühabetin. Izgjata kutinë e duhanit të mbushur me duhan Sulove dyllë të verdhë e të grirë për shtatë palë qejfe, po ai nuk e pinte.

— Hë, si dolët me bujqësinë sivjet?... Ç'kemi andej nga kooperativa? — Shitësi ishte një buçko rreth të pesëdhjetave. «Ka njerëz në botë! Shiko sa interesohet përfshatin tjetri! — mendoja tek u përgjigjesha pyetjeve të tij. — Me siguri do të ma zgjidhë hallin.»

— A patën arrat? Po mollët? Po rrush a ju kanë mbetur më pa vjelë? — vazhdonin pyetjet e baxhanit. Ai fliste e lëviztë sikur kërkonte dicka. Unë u futa drejt e në temë.

— Jemi keq me këto, — i thashë dhe i zgjata një goxha listë me pjesët e këmbimit. Ai e mori, u ul ngadalë në karrige dhe, pasi i hodhi një sy listës, filloj të shfletonte ca kartela. Unë futa kokën nën xhamin e sportelit dhe nuk i ndaja sytë nga lista.

Në fillim ai spontoi kërkesën për bobina, pastaj atë për ingranazhe të marshit të tretë. Mua po më shkrinte gjaku. Kur arriti te guarnicionet e testatos, m'u duk se u prish në fyttyrë. E shtyu listën mënjanë dhe vuri duart në témtha.

— Aman, xhan i vëllait, — iu luta, — se jemi në kohë fushatë! Na there, po na le pa gjë!

— Ai u mendua pak, ngriti sytë në tavan dhe tha: — Më zutë ngushtë, mor burrë! Të fundit që kam ty po ta jap, se jeni malësi ju. Pastaj më pëlqeve në muhabet — ... Më erdhi t'i hidhesha në qafë, po nuk n'a linte banaku me xhamin ndarës.

— Autorizim keni? — më pyeti shitësi, duke e ndryshuar disi zërin.

— Kam, pos! Se, që ta marrësh vesh, jam furnitor i kooperativës, — thashë kështu dhe ia zgjata.

— Me këtë furnizohem tërë vitin.

— A, a! Jo, xhan i vëllait! Ky nuk të pi ujë këtu. Te ne, sa herë që vjen, duhet të sjellësh autorizim të ri, — ma priti qetë-qetë, duke i mbyllur kartefiat. Çfarë të bëja? Preka dhe një herë kutinë e duhanit në xhep, po ishte e kotë, ai nuk e dridhte. Atëherë u mundova ta bindja se autorizimin që donte do t'ia sillja patjetër të nesërmen në mëngjes. Por, ai nuk më vuri vesh.

«Hë, të keqen, jo! Ja, kështu duhet të jetë njeriu në punë! S'u bëka dëngla — mëngla me këtë! Qenka i prerë, qerratai! Këtij lloji i duhet pirë shëndeti, në dollj», mendova dhe vështrimin e treta jashtë derës.

— Dërgo nesër njërin nga shoferët, ose hajde vetë dhe do t'juat jap të gjitha, — tha ai. Pa dalë mire nga dera, e dëgjova të vazhdonte: — ... Dhe të

vini me mend në kokë, xhani i vëllait! Kështu i thuhaj dhe Ahmetit! — përfundoi, duke mbyllur plotësisht syrin e majtë.

Nuk e zgjata. Po atë ditë ia mbatha prapë për në kooperativë. Ku rrihej në qytet në këtë kohë florri për të mbjellë të lashtat!

Mora disa autorizime dhe të nesërmen bashkë me Ahmetin u nisa për në qytet. Ai sikur nuk besonte kur i thashë se autorizimi më pengoi, pa pjesët e këmbimit do t'i kisha përlarë qysh të djeshmën. Ora 7 e mëngjesit na gjeti para dyqanit. Ai birkoja kishte ardhur më përpara. Sa na pa së largu; fërkoi duart.

— Ore, Ahmet! Unë çuditem me këtë. I vura veshin edhe dje. Ja, kështu i fërkonte duart. Ftohtë nuk është. C'dreqin ka xhanëm?!

— Ah, nuk i njeh ti, Laze, këta, jo; ke të drejtë që pyet. E kanë si sëmundje, të uruarit.

— Mirë se erdhët! — na uroi shitësi, duke na shikuar nga duart. Unë nuk e zgjata, po fët e fët nxora nga xhepi i brendshëm i xhaketës njériri nga autorizimet.

— Urdhëro, — i thashë. — Sot kemi ardhur vërtet me mend në kokë, siç më porosite dje.

— Të shohim njëherë! — ma ktheu. Pastaj vari buzët, më mori autorizimin, e pa me kujdes dhe vajti prapë te kartelat.

— Bobinë nuk kemi, — dëgjova zërin e tij tek fliste pa e ngritur kokën.

— Si, ore, nuk ke?! Po a nuk më the dje se, demek, po të vinim sot me mend në kokë, do na i jepjet të gjitha?

— Ajo llafe që për dje, mor djalë i mbarë. Po ti ke harruar se që atëherë e deri tani kanë kaluar 24

orë. Nuk e kupton se «ç'sjell minuta nuk e sjell moti?» Ndaj mos u sëkëlldis aq, se nuk je as i pari e as i fundit!

Si ndenjëm dhe ca pa folur, e pashë me vend ta nanurisja dhe një herë këtë punë.

— E, si do t'ia bëjmë? — e pyeta pa shpresë e me gjysmë zëri.

— Le të vijë Ahmeti pasnesër, se do mundohem t'ia gjej. Ti mos u lodh, se t'u bënë dy herë të ardhur! — më qau hallin ai, duke shikuar shoferin mënjanas. Në atë kohë në dyqan erdhën tre vetë të tjerrë. Si u përshëndetën me shitësin, njëri nga ata, një mesoburrë me një xhaketë meshini, iu drejtua babaxhanit pa tekli.

— E, çfarë thotë i zoti i dasmës? I dha udhë punës apo jo? — pyeti, duke na shikuar me bisht të syrit.

— U kanë rënë bateritë e nuk u vete zëri, më duket; po nejse. Janë edhe shelegë, po do bëhen...

— tha shitësi.

Kur muhabeti, po sillej degë më degë, neve na u duk vetja e tepërt dhe u larguam. Pas pesë minutash lugët tonë u ngulën në pilaf.

— Ç'është kështu, or Ahmet, më qafsh?! — i thashë shoferit.

— Asgjë e jashtëzakonshme. Ai na e tha shqip. Siç i erdhëm, na përcolli.

— Pse, qysh t'i vinim atij syrtyku?!

— Po, pér çfarë të pyeti dje ai? — vazhdoi Ahmeti, duke më shikuar në bebe të syrit.

— Pér punët e bujqësisë më duket, pér mollët, rrushtë, pér arrat... Shitësi muhabete bujqësore bënte. M'u duk shpirt njeriu, — ia ktheva.

— Hë, Laze, të paçim! Aty më qëndro! Po pse, ore,

u merákos pér punët e bujqësisë ai? Ha-ha-ha! Të vish te ky me mend në kokë do të thotë t'i mbushësh duart, mor i uruar!

Rrudha sytë.

— Hajde, hajde, q'vete! — thashë. Ne në fshat inatosemi me viçin e Sulos se ha dy kallëz misër dhe bëjmë njérën, kurse ky bandilli dashka ta dorovitim me të tëra ç'prodhon bujqësia!

— A ka kohë që punon këtu qerratai?

— Po ka ca, se ai i pari ra nga fiku. Kishte zakon më të keq. Ishte mësuar me pare.

— Si, ore, e shoftë mortja, e shoftë!... Unë do vete prapë atje, do e zë pér fytì dhe do ia nxjerr sytë kalipoça, — thashë dhe përplasa lugën në pjatën e pilafit, sikur do të nisësha që atë çast.

— Joo! Aman, t'u bëfsha, Laze! Lëre dhe kësaj here, se nuk kemi ku t'i gjemë pjesët e këmbimit pastaj! — m'u lut Ahmeti duke më shkundur ca korrë orizi që më kishin mbetur në xhaketë.

— Nga këto «amanet» tuaja ka ardhur deri Lëtu ai birkoja, po jepini ju, jepini sa të mundni, se nuk e ka plotësuar akoma peshën e majmërisë, — thashë duke dredhur një cigare. Trupin kisha aty po mendja kushedi se ku kulloste.

\*  
\* \*

Pas dy ditësh Ahmeti i solli vërtet mbrokullat e makinave, po unë nuk e pyeta si i vajti pazari. Sa herë shihja mollë, arra, rrush në kooperativë, mendja më shkonte te pjesët e këmbimit, dhe shitësi nuk më shqitej nga sytë. Pas disa ditësh po shko-

nëm në kooperativën fqinjë të merrnim farë koçkulle. Nuk më tradhtoi kujtesa. Në një kthesë u dhanë tre vetë përpara makinës. Dukej që do kishim të njejtën rrugë. Ahmeti frenoi. Menjëherë e njoha njërin prej tyre. Ishëtë shitësi i pjesëve të këmbimit. Shoferi e ftoi në vendin përpara. Ai hezitoi për një çast. Shikoi si i habitur nga dy të tjerët dhe iu drejtua njërit prej tyre të zinte vend në kabinë. Vura re se fytyra i ishte bërë më e zeshkët dhe e têrhequr. Në dorë mbante një rrjetë, brënda së cilës qëndron te diçka e mbështjellë me gazetë. Nga ai që erdhinë kabinë mësuam gjithçka. Ish-shitësi i pjesëve të këmbimit tani ishte bërë kooperativist dhe po punonte direjtpërsëdrejti në prodhim. Kontrolli punëtor e kishte këshilluar të ndërronte klimën.

— Me mend ně kokë, xhan i vëllait! — i thashë atij, kur zbritëm.

**SIIJA LASHE SHENDENE PAZARIT.**

**SI TA PASSE** DANS LA VILLE DE  
LA CHAISE-DIEU, TU SAIS BIEN QU'IL FAUT  
TE FAIRE ARRÊTER. SI TU TE FAIS ARRÊTER,  
TU SAIS BIEN QU'IL FAUT TE FAIRE LIBÉRER.

Ta themi midis nesh e ta lëmë këtu, duke i vënë sipër një gur e një plis. As vetë nuk më besohej në fillim se unë Laze Selimi do të isha aq i zotipër të shitur e për të blerë. M'u ëmbëlsua ai i flamosur pazar dhe meazallah se, i shqiteshë dot. Më kishin rënë përhise ca huqe që rrallë i ka njeri. Dhe tani nuk e kam shkoqitur mirë, në linda i atillë, apo më vonë e fitova atë zanat. Nga prindët nuk kisha ngjarë. Babai në gjallje të tij, ndjesë pastë, një herë në 10 vjet blinte një gomar, kurse nëna mezi shiste një kaposh. Si duket, unë e mora me praktikë zanatin. Sefte nuk mbaj mend me se e kam nisur, por di se, sa filloj të më ëmbëlsohej pazari, mezi prisja të vinte e djela. Blijë dhe shisja, po amë dhe për qarin nuk qahem. Më pati qëlluar në fillim të kthehesha buzëvarur e xhepshpuar, kurse më vo-

në nuk isha më axhami. Le të kisha njëqind halle në kokë, po të futesha brenda mureve të pazarit, e ndieja se merrja frymë lirisht. Më ishin mësuar veshët me të pëlliturat e blegërimat e gjësë së gjallë dhe me zallamahinë që të shkulte mendjen e kokës. Apo nuk kisha dhe shokë atje! Për shembull Kame Kokutën nga Ferrasi. Mustaqet i vareshin mbi buzë si kallnj thekre. Kishte sy të mprehtë që, po të të shikonin drejt, të shponin si turjelë. Po gojën? Në çast të turbullonte! Futeshe në pazar me mendtë e tua dhe, po të llafoseshe sado pak me Kamen, dilje që andej me mendtë e tij. Sa e shihja, kujtoja ç'thoshte gjithnjë, si të mësuar papagalce: «Kalë do ti, xhan i vëllait? Ja ku e ke! Kalë më të mirë, fshi-je me sukull, se nuk gjen! Revan të ka, i urtë – sa një çilimi. Katër vjet sa i ka mbushur. Nuk i ka dalë dhëmbi i tagjisë...»

Afër Kames të zinte syri një mesoburrë me çizme, me një palë qillota shajaku dhe me një xhaketë meshini. Kishte më pak llafe se Kamja. Cigaren nuk e hiqte nga goja. Kutinë e kishte përherë të mbushur me duhan dyllë të verdhë, të grirë imtë. Mban te çakmak, shkrepëse, eshkë e masat. Ky ishte Metaliu nga Qyteza. Qejfi i tij qenë bagëtitë e imta.

— Mallin e trashë ua kam lënë të tjerëve unë; shes e blej vetëm dhen e dhi, — thoshte, po ta pyesje. Kishte raste që shiste edhe ndonjë gomar të lagjes, po hak nga i zoti nuk dihet sa merrte. Ku shkolepsej puna e tij. Ai një herë në ditë e zbërthen-te gojën.

Rallë dukej në pazar edhe një farë Nasi nga Myzeqeja. Ai ishte tifoz i lopës. Veç duke blerë e kishim parë. Dreqi e merrte vesh se ku shiste.

Mbante një takije më të bardhë se qylafi im. Sytë i kishte gjithnjë si pér gjumë. Nuk sorollatej shumë pazarit. I kishte hesapet të shkurtra.

\*

Inatin më të madh unë e kisha me Muço xhambazin e qytetit. Ai më pati prishur punë disa herë. Sa e bëja «pér hair» me ndonjë myshteri, fup vinte Muçoja dhe madjaloste hesapin. Po edhe unë me duar kryq fare nuk rrija. I pështyja në çorbë kur thonë. I vinte inat sa më s'bëhet, po s'kishte ç'të bënte, se edhe shokët e mi si mizën në dhallë e shikonin Muçon. «Do t'ua ketë punuar edhe atyre malukati, — mendoja, — ndaj nuk duan t'ia shohin bojën.»

— Eshtë dinak si dhelpra, qerratai, — thoshte ndonjë, kur vinte fjala pér Muço xhambazin. Dhe, ke parë ti! Një herë e pashtë tek po bënte pazar me një fshatar. Donte t'i blinte një goxha mushkë «gjeskë». Sa e vura re së largu, «do t'ia galinos pazarin», thashë me vete. Iu afrova si me marifet të dyve, që të dëgjoja qoftë dhe një fjalë. Muçoja jepte 5500 lekë, i zoti i mushkës kërkonte 6500.

— Pér 6000, mushkëa është imja! — i them unë fshatarit. Muços iu nxì surrati. Më shikoi gjithë inat. Pastaj u kthyë nga i zoti i mushkës.

— Me mua e nise pazarin, me mua bitise, or xhan i vëllait! — i tha atij.

— Unë kam mushkë pér të shitur dhe do e jap ku të më dojë ai shpirt qejfi, — ia priti fshatari, duke shikuar nga unë. «Tëkqeqen e gojës, — i thashë me mend, — se e bëre të pëlcasë!»

— Mirë. Të jap 6200 lekë. Nëma mushkën! — e ngriti zérini dhe pazarin Muçoja dhe diç po i thoshte në vesh fshatarit.

— Jo, or, jo! Nuk tundem nga imja unë! — ia kthente ai i krekosur.

— Merr 6400 lekë aty dhe hajt, i gjuar i ngrënç! — i thashë unë, kur m'u duk se e vura Muçon përpara.

— Të qoftë, or burrë, se unë po e ndjek më tutje! — ia patiu xhambazi, dhe u bë tym tutje pazarit. E pashë që ma hodhi qerratai. Pastaj e merrni me mend që desh u therat me thonj me të zotin e mushkës, se s'kisha për të blerë gjë. Kot isha futur në valle. — Ti që më prishe pazarin, merr mushkën për aq sa the, o të bëhet nami sot! Burrë je, apo grua!? — m'u çor fshatari gjithë kacabunj.

«Ah, që nuk fole edhe një herë, o Muço, pa ta tregoja unë qejfin!» thashë me vete. Ç'të bëja! Ia mbathat me të katra dhe e lashë fshatarin kalli në mes të pazarit.

Kohët e fundit nga pazarit po dukeshat më rrallë. Nuk bëja dot si më parë. Në shtëpi vlonë sherrit me nënën dhe gruan. Dajak të fortë më futën dhe në brigadë. Madje, ma nxorën emrin edhe në mbledhjen e frontit si njeri që e harxhoja kohën me srollatje. Pra, siç po merrnin punët, e s'ndjeval se do të më telendisnin keq. Blija një lopë të dielen, të hënën më thërrisin në kryesi të kooperativës.

Kurse me kafshët e samarit e kisha më lehtë. Me ato punoja në fshat, ndaj brigadieri e bënte një vesh shurdh e një sy qorr, kur më shikonte me dytri mushka në fushatë. Bile, një herë më lavdëruan si punëtor të mirë, demek se kisha futur 250 ditë-pune vetëm në një tremujor. Por kjo lëvdatë më hapi telashe, për djall.

— I ka bërë me mushkat gjithë ato ditë, — ma veshi njëri në një mbledhje. Pastaj ai u drejtua nga brigadieri dhe pyeti:

— Kush e lejon Lazen, mor jahu, të mbajë mushka mbi statut?! Çfarë bëhet kështu në brigadën tonë?! Ka rregulla apo s'ka?!

Ç'të thosha?

— Hë, mo, se pak ditë do t'i mbaj dhe do t'i shes, — fola si miza në qyp, për të qetësuar gjakrat. Mirëpo, dreqi e mori! Sikur të paskësha hedhur benzinë në zjarr!

— Nuk merrke vesh ti, mor burrë! Po ajo mbledhja e frontit kaq shpejt të paska dalë nga mendja ty? Apo do të ta bëjmë si Nuro Pllocës? U betova e u përbetova se, sa t'i shisja edhe ato flama e nuk më shikonte më pazari.

— Sa herë ke thënë kështu ti, aq të mira qofshin! — vazhdoi të fliste pa të keq Sanija.

Në fund të javës i shita të dyja mushkat e telpërtë. Nuk bëhej më shaka me këtë punë.

Kaluan ditë, javë dhe muaj. Ç'është e vërteta, në fillim zor e pata. Në daç besoni, në daç jo, po të shtunave dhe të dielave me mendje në pazar rrija. Merak i madh më kishte mbetur t'ia hidhja sikur vetëm një herë atij Muços, pa tjetër s'desha,

\* \* \*

Pas ndonja gjysmë viti zbrita një të diel për punë në qytet. Nuk m'u ndenj pa dalë edhe në pazar. Për të shitur dhe për të blerë nuk kisha, po ashtu, kot vajta. Sa më panë shokët, m'u lëshuan dhe më morën fryshtë.

— Po ku ke qenë, or derëbardhë, kaq kohë?! Ne kujtuam se mos u sëmure! — tha Kamja duke më përqafuar.

— Unë desh të çrrregjistrova fare, si Nuro Verigjen. Më vinte mendja se mos të kishin bërë pestil edhe ty në ndonjë mbledhje fronti, — tha Yzedini, duke më rënë krahëve.

— Ashtu, ashtu e pësova dhe unë, — u thashë me gjysmë zëri.

— E, ore, e! Mos i shit rruazaxhiut rruaza ti! Kujt ia thua ato! Edhe neve na kanë ardhur rrrotull, po nuk na e kanë gjetur anën! Ku mbahemi ne! — ma ktheu Kamja, duke më shkelur syrin.

— Nuk po na lënë kooperativat radhë, o Laze! Na grinë! E përlajnë bagëtinë pa rënë përdhe! — u ankua Metaliu.

Nuk ndenza as një gjysmë ore me ta, e megjithatë, do ti të më futen prapë Mizat!

— Mos dil pa gjë nga pazari! — më tha Metaliu.

— Nuk kam ardhur për pazar sot, po një lopë, për besë, ma kishte qejfi ta blija, — iu ktheva. Kamja, si më i mençmi, e thithi se ku e kisha hallin, dhe më tha si mënjanë:

— Sa do?

E pashë se ishte e kotë të kundërshtoja, ca më tepër se këto fjalë po më shkonin sipas oreksit. Mora

paratë dhe bleva një lopë «qumështore», siç më tha një kavajas. Pasdite u nisa për në fshat. Unë afrohu fshatit, frika shtohu! Po kjo! Unë isha ai që blija kope me dhen e dhi dhe nuk ma bënte syri tërr; kurse tani trembesha prej një bishti lope. U detyrova të prisja natën për të vazhduar udhën...

Vërtet nga fshatarët e mi shpëtova atë natë, por hallet i hoqa nga nëna e gruaja në shtëpi.

— Ç'e do lopën, or lumëmadh! Apo do të dalësh në stan me të? — ma priti nëna e inatosur.


— Do të shes tjetrën, se u plak, de! — iu përgjigja me frikë se mos fillonte ndonjë rrebesh.

— E, a derëzi, — ma priti gruaja. — Po mos kigajle, se edhe unë do të të bëj për një lek në mbledhjen e frontit. «Një në xhep, — mendova. — Nuk qenka thënë të fitoj ca para qyl».

\* \* \*

Me të keq e mbajta lopën nga Kavaja nja tri javë në shtëpi. Kur e pashë se isha futur në mes dy zjarreve, nuk durova dot, po i kërkova leje brigadierit të shkoja në qytet, demek, për kryeshëndoshë te një shok. Mëngjesi më zuri në të hyrë të pazarit. E kisha ndarë mendjen t'ia shisja myshteriu të parë dhe të mos merresha më me këto punë sa të isha gjallë. «Ata që nuk merren me pazarllëqe, në fund të fundit, çfarë i ka gjetur? Ishalla nuk më sheh njeri dhe e mbyll mirë!»

Më dhanë dy vetë pazar. Nuk më qëndroi kari i gjékundi. «E po pa një çikë fitim nuk dò e shes Gastaren e fundit, de! — thashë me vete. — Mbase



nuk më del përpara Muçoja e nuk ma prish pazarin!»

— Ja, ku qenka një lopë e mirë dhe këtu, — ndjeva të flisnin prapa meje. Ktheva kokën andej nga vinte zëri, por çfarë të shikoje! Veterineri i koooperativës sonë dhe tre të tjerë qëndronin më këmbë

përballë meje. Më ra qelli në kokë nga turpi. Mallkova veten. Të të zinin herën e fundit, nuk i thoshin shaka.

— Ku e ke gjetur këtë lopë, or ters i fshatit? — më pyeti veterineri. Rashë ngushtë, po ia thashë të vërtetë një për një.

— Ashtu! — m'u përgjigj ai. — Shumë mirë. Ne prandaj kemi dalë, duam të blejmë disa lopë për kooperativën. Kot qenke lodhur deri këtu!

— Sa keni blerë gjer tani? — e pyeta unë, si më shkru pak gjaku.

— Nja tri. Pra, çoje lopën tek ato dhe hajde me ne!

Pashë c'pashë, e vura Gastaren përpara dhe e çova te shoqet, pa bërë gëk.

— E bëjmë në fshat pazarin, po tani hajde e na trego xhambazët, se ti i njeh mirë! — tha Halimi, kur e pa që unë po përtypesha. «Nga xhambazët dashkan të blejnë lopë këta?! — u habita. — Hajde ustallarë, hajde!» por Peroja sikur ma lexoi mendimin.

— I duam t'i njohim, që të mos u afrohemë! — më tha.

Atë ditë pazarin na vajti mbarë.


— Shkrije talentin, o Laze, se me kooperativën nuk do të vish të blesh lopë më kurrë! Tani ne krijojmë bazën tonë dhe nuk do t'ia shohim më sytë pazarit, — m'u drejtua veterineri. «E, ore i dashur, e! Dhe ti të më lutesh, nuk të vjen Lazja më në pazar, jo, sikur dynjaja të përmbyset», mendova.

Asaj së diele nuk lashë kusur pa bërë. Dilja pa drujtje me shokët e mi. Pastaj e kisha dhe herën e fundit. Tri herë ia prisha pazarin Muços. Vetëm druari i mbeti pa përdorur me mua, se për llafe nuk la kusur derëziu. Në mbrëmje, si vumë tufën e lopëve

përpara, u nisëm pér në kooperativë. Shokët, bënин  
ç'bënин dhe më lëshoheshin nganjëherë. Predhat e  
tyre binin mbi lopën time, e cila atë të diel bëri një  
xhiro nëpër pazar dhe tanë po kthehej e lodhur në  
fshat.

— O-ha, Gastare, se nuk do fshati të dalësh jash-  
të kooperativës! — i bërtisja lopës. Kisha vetëm një  
shpresë. «Ndofta e marrin vesh shpejt se hoqa dorë  
nga sorollatja dhe më lënë pa më thumbuar.»

... që tani është kohë e vjet e sëmundjeve, që vjet tashmë  
kryeqyteti i Shqipërisë ka qenë qyteti i Vlorës.  
Në këtë kohë e vjet e sëmundjeve, që tani është kohë e vjet  
e sëmundjeve, që tani është kohë e vjet e sëmundjeve, që tani është  
kohë e vjet e sëmundjeve, që tani është kohë e vjet e sëmundjeve,  
që tani është kohë e vjet e sëmundjeve, që tani është kohë e vjet e sëmundjeve,



## KUR ISHA BEQAR.

Tani jam i martuar, bile dhe kandidat për babë. Në qershori u fejova dhe nuk e zgjata më, pas një muaji bëra martesën. Mirëpo kalova shumë telashe sa arrita gjer këtu. Në radhë të parë, u çlirova nga ngacmimet e nënës.

— Shkollën e lartë e mbarove, në punë je, tani vetëm nusja të mungon, të keqen nëna! — më thoshte orë e çast. — Hë, si thua? Të pëlqen filanka? T'i futim njeri?


Sa herë zinte në gojë këto muhabete, unë qeshja e ia ktheja:

— Eshtë shpejt, moj nënë, pse të nxitohemi?

Ajo më shikonte drejt në sy e më përgjigjej me gjysmë zëri:

— Vërsa jote u bënë me kalamaj, ti akoma nuk je fejuar!

Babai vetëm dëgjonte. E kam ca serioz tim atë.



... Fol nëna e kthe unë, u rrokullisën dy vjet dhe hyri i treti, që nga koha kur kisha mbaruar shkollën. Njëherë, kur e pashë se prindët, të dy tok, më vunë përpara, nuk kisha nga t'ia mbaja. Ndaj u bëra një dredhi. Të paktën, të shpëtoja për ca kohë nga kërçenimet.

— Nusen do ta gjej vetë, — u thashë. — Dhe do t'jua sjell në shtëpi.

Nëna kërceu përpjetë nga gëzimi.

— Të keqen e gojës, — ma priti, duke më përqafuar. — Ishalla vjen shpejt ajo ditë!

Babai më shikoi pak si i habitur nga guximi që po merrja faqe tij, pastaj nxori paketën dhe e tymosi. Si e thithi nja dy herë, tha:

— Mirë, or shejtan, mirë, sevdallisë e na e sill!

Mendova se pas kësaj dredhie do të shpëtoja e s'do të jepja më llogari për nuse, po jo, or ti; qenkësha i gabuar! Jo më vonë, por pas ndonjë muaji, ime ëmë më pyeti si me terezi:

— E çfarë bëre? Ia vure syrin ndonjëres, apo jo?

Unë krova kokën.

— Punët e mira bëhen avash-avash, ndaj mos u mërzit! — iu përgjigja. Por ajo s'm'u nda, që s'm'u nda! Nuk kishte natë të mos bëhej ky muhabet në shtëpinë tonë. Prandaj fillova të kthehesha vonë nga pazari, kur shihja që drita ishte fikur. Futesha në majë të gishtave, të mos zgjoja prindët. E ata, sikur më prisnin syhapur! Me të dëgjuar që hyja, babai pyeste nënën:

— E, moj grua, erdhi tersi ynë?

— Ashtu më duket.

— Vetëm është dhe sonte, qerratai?

— Pa ta shikoj njëherë, mor burrë! — ia kthente ajo dhe fap hapte dritën.

— Ta paskan mbledhur keq, — më tha një ditë, si me të qeshur shoqja ime e fëmijërisë, Teuta, vajza e Refit Këpuçarit.

— Pse, moj, nga e di ti!? — u habita unë.

— Po plakat ç'nuk i thonë njëra-tjetërës! — I hapi zorrët e barkut.

«Po kjo shejtane, xhanëm, ç'futet në këto mese-le», mendova:

— E shoh se nuk je nga ai mall ti, që të gjesh nuse! — m'u shkreh nëna një mbrëmje. — Kot na mbajte me fjalë! T'i futemi Sheros, për të mbesën, them unë, dhe ke për të parë çfarë thëllëze ka për të dalë! Apo nuk ka atë bukuri! Perri, ore, perri është! T'i marrësh kokën dhe të ikësh!

— Jo, jo, — iu përgjigja. — Ki një cikë më shumë besim tek yt bir! Të kam thënë që do ta gjej vetë!

Dhe fillova të vrisja mendjen. I kalova para syve të gjitha çupat e qytetit tim. Njëres, më dukej, sikur nuk i shkonin flokët me fytyrën, tjetra sikur ishte një tre centimetra më e shkurtër nga ç'duhej, e ku di unë... Gjithkujt do t'i gjeja domosdo një cen. Fati meja, për shembull, më bëhej se e hidhte pak si mënnjanë këmbën e djathë. I gjykoja vajzat sikur ato, me një fjalë timen, mund të binin përmbyss mbi mua.

Dhe erdhi koha që i vura syrin njëres. E kjo ishte një komshie e re. U betova me vete që pas një muaji taçoja patjetër në shtëpi e t'ua nxirrja përparrë

prindërve, sipas fjalës që u kisha dhënë. Mirëpo edhe ajo që unë i kisha vënë syrin nuk flinte. Si dukej, e kishte pikasur me kohë se në cilën qafë do të dilja unë. Një ditë, si rastësisht, takova dajën e saj. Njireshim qysh më parë me të. Si këmbyem disa fjalë të zakonshme, e pamë me vend të futeshim në një lokal për kafe. Kur kamerieri na solli filxhanët, nisëm t'i rrufitnim në heshtje. Pastaj daja më pa gjatë në sy dhe më pyeti:

— A e di si e kam hallin?

Mua menjëherë më shkoi mendja tek e mbesa. «Kushedi seç do t'i ketë molloisur ajo, — mendova, — dhe hajde e dëgjoje!»

Ai vazhdoi:

— Më duhen nja 1500 lekë. Ke të m'i huash? Pas 15 ditësh t'i kthej.

Unë sikur u çlirova. «Po hë, mor, të mori e mira, të mori, se më ngrive gjakun!» thashë me vete.

— A të pret puna gjer nesër, sa t'i tërheq nga arka e kursimit, — e pyeta. — Se tani është e myllur.

Ai sikur u qetësua.

— Ti je beqar dhe ma do mendja se do të kesh kursyer mirë, apo e kam gabim? — Priti disa sekonda të merrte përgjigje, po kur e pa se unë nuk po e hapja gojën, tha:

— Kam time mbesë unë, ti duhet ta njohësh! Ajo, që thua ti, tri libreza kursimi ka. «Po nuk gjeta një djalë që të ketë para sa unë, sakën se martohem», thotë shejtania.

Ndjeva se më mbuluan djersë të ftohta. «Mos është i lidhur me këto fije edhe borxhi që më kërkoi? Po, po, kjo, s'ka si të jetë ndryshe, — mendova në ato minuta. — Ndaj, ajo bija e botës, herë më afrohej e

herë më largohej, që të merrte vesh buxhetin tim, duket! Hajde, çupë që na qenka, hajde! Mirë që i nxori brirët qysh tani, se për pak desh më fiku derën!» E vendosa në vend: Nuse si ajo kurrë të mos gjendej! Këto lloje duan të martohen me paratë dhe jo me njeriun.

— Nesër takohemi në orën 9, por, të lutem, mos m'i vono shumë lekët, se vetëm ata kam! Më mbetet kostumi pa bërë pastaj, — e gënjeva dajën vetëm për t'i matur pulsin.

— Oh, po që se të pengokam, djalë i mirë, lëre fare këtë muhabet! Gjej dhe gjetkë unë, se nuk kam aq ngut! — ma ktheu.

Atë natë u ndava me të dhe i hoqa vizë së mbesës.

— Ke zënë shoqëri të re, hë? — më pyeti të nesërmën çupa e Refitit, Teuta.

— E po, njerëz jemi, de! — iu përgjigja, duke vrarë mendjen të gjeja se ku më kishte parë me dajën e komshies së re.

— Mirë, mirë, — shtoi ajo, — po ta dish se këtë herë ke rënë në derë të fisme.

— T'i futemi mbesës së Sheros, se mbete pa gjë, mor bir! — më tha nëna, kur e pikasi se në një vend nuk më kishte ndezur. Unë heshta dhe nuk vonoi e m'u fut një shok për një goxha vajzë nga Shtyllasi. Ai po ma lëvdoi e ma lëvdoi sa më s'bëhet. Pastaj ma shkoqi më tej muhabetin. Zelikon kush nuk e kishte kërkuar, po ajo i paskësh shtyrë tutje, se dashkësh

një burrë që të ishte me banim në qytet denbabaden, të kishte shtëpi private, kurse motra e vëllezër jo, se ata t'u bëkeshin ferra nëpër këmbë!

Shoku foli e foli dhe priti të merrte përgjigje.

— I thuaj asaj Zelikos të shikojë pér ndonjë tjeter, se unë, — ia ktheva, — nuk ia kam ngenë. — Atë ditë po kthëhesha ftyrrëngrysur në shtëpi, kur, pér dreq, takova rrugës Teutën. «Po kjo? — thashë. — Sa herë kam halle nuseje unë, me këtë do të piqem!» Nisi në çast të nxirrte kunja me mua.

— I vetmi paske qenë pér shoqëri, o Titi! Ke filuar me fshatin tani, hë? Nuk po të mjaftoka qyteti!

Unë u pengova e desh rashë. Ajo filloj të qesh-te nën zë.

— E moj, dhe ti! Gjete rast të tallesh! Gjithkush mund të rrëzohet! Nuk shikojnë sytë, po mendja!

— Tamam. Ti mendjen e ke në Shtyllas! Ha-ha-ha! — ia shkrepit ajo gazit me sa mundi.

\*

— E, mor firaun, do ta gjesh yetë nussen siç na ke thënë, apo të fut Sulon nga kazaja e Sulovës, se i ngjit atij? — më tha një ditë babai. Nuk arrita ta kuptoja, e kishte me të vërtetë, apo bënte shaka.

Pas ca ditësh m'u futën shokët pér njérën nga qyteti fqinj. Ata bënin be e rrufe se ajo vajzë i kishte shoqet të rralla. Qenkësh ftyrrëhënë, duarargjendtë, fjalëmjaltë... shkurt, të gjitha të mirat tek ajo qenkëshin mbledhur! Mirëpo, unë kisha rënë një herë nga fiku. Nuk mund ta haja më kollaj kokrrën e ullirit. Kësisoj, e gjeta me vend të interesohesha

për nusen që po më rekomandohej. Po edhe bija e botës të njëjtën gjë nisi të bënte, megjithëse ishim pak larg. Bashkë me shokët që iu futën këtij muhabeti, pasi u veshëm me rroba të reja e pasi kaluam nga berberi e u pilluam mirë e bukur, u nisëm për tek ajo. Kur arritëm në qytetin e saj, rrahëm rastësisht, por s'që e thënë. S'e pamë gjëkundi. Si u bëmë telef, u ulëm të pushonim te një stol në një lulishte. Më në fund Reema i tha Kiços:

— Pse, ore, të mos i vemi në shtëpi?

— Po s'pati kundërshtim Titi, unë gati jam, — ia ktheu ai.

— S'jua kam prishur kurrë, — shtova me ngut.

— Si mund t'jua prish tani!?

Filluam të ecnim me sa na hanin këmbët në drejtim të periferisë. Më në fund arritëm përpara një shtëpie të rrethuar me pemë. Nuk e zgjatëm, po hymë brenda. Ngjitëm ca shkallë të larta dhe ndaluam sipër në korridor. Na priti një grua e shëndoshë rreth të pesëdhjetave.

Kur po hiqnim këpucët, Kiçoja më foli në vesh:

— Shiko, se mos na bën ndonjë të pabërë, se i ke qejf proçkullat ti, e di unë.

Gruaja më hodhi duart në qafë. Nuk vonoi shumë e u dha në derë e bija. «Po hë, moj zogëzë, ç'u bëre, se na plase!» thashë me vete dhe ndjeva zemrën të më rrihte fort. Doja t'ngulja sytë, po nuk më linin tre palë sy të tjerë. U ulëm. Sapo nisëm pak muhabet, erdhi i ati, një goxha burrë i trashë. Gostitja tani vazhdonte me raki, llokume e kafe. Fjala nxiste fjalën e biseda dridhej degë më degë. Përse nuk folëm, veç për fejesën jo. Kur mbaruam së diskutuar për filmin e ri që kishte dhënë televizori një na-

të më parë, unë shpova fshëhurazi Rremën, që të mos e zgjaste, të ngriheshim e të iknim, kur, do ti! I zoti i shtëpisë më tregoi mua me gisht e iu kthyeshë shoqes:

— E, moj grua, a të pëlqen ta bëjmë dhëndër këtë djalë? Fol, dhe hair na qoftë që sonte!

Si e pashë që shokët e mi s'u ndjenë, e mora fjalën vetë:

— Kemi kohë për atë muhabet, o xha Rushit!

Ai më shikoi vëngër. Biseda jonë mbeti pezull. Vajza ndryshoi në fytyrë dhe e la vrapin në kuzhinë.

— E, si t'ul duk vajza? Me siguri të pëlqeu shumë, — më pyeti Rushiti, duke më shtrënguar krahun. Mendova se mos ishte i dehur e fliste qesim, por jo. Edhe kur po dilnim, ai nuk hoqi dorë nga e tija. Po bëja sikur nuk po i vishja dot këpucët, që të fitoja kohë t'i përgjigjesha. Sytë më vajtën edhe një herë padashur te copa e stofit të zi varur në mur, ku rrinin dy kaponj të mëdhenj të qëndisur. Atë do ta kishte bërë patjetër dorëargjëndja ime.

— Unë, or xhan, nuk jam fanatic si disa, — vazhdoi i ati i saj. — Pëlqehuni dhe merruni! Ju u patë tani.

Ai nuk po ma lironte krahun. Prá, i donte punët çak-fak, s'po bënte shaka. Kur e pashë se m'u bë rrodhe, iu përgjigja:

— Unë vajzën tënde tanë për tanë e njoh vetëm nga jashtë, si kallëp. Kur ta njoh e kur të më njohë më shumë, ulemi e flasim. Ti, besoj, do të na lejosh, se, siç e the edhe vetë, nuk je fanatic...

Atij i kërceu një damar në ballë. Shokët ma bënnë me shenjë t'i zbrisja shkallët shpejt. Dhe unë

ashtu bëra. Ndjeva që prapa zërin e fortë dhe të çjerrë të Rushitit:

— Mor zonzop, po ti paske qenë...

Lëre se ç'nxori nga goja! Pastaj u pa puna. U lëshuam jashtë me të katra, se ai hoqi shapkën e ma vërviti rrëzë veshit. Tek vraponim, dëgjoja ende të sharat e Rushitit dhe mallkoja veten që kisha shkuar si breshka te nallbani.

— Shpejt, or, shpejt, sa të arrijmë kthesën! — po më nxiste Rrema, — se ka edhe çifte ai e na i bën tulet shoshë me saçma! Nuk kisha hall tjetër, po kush i dëgjonte njerëzit tan! Apo nuk kishte dalë e po na bënte sehir e tërë lagija! Me siguri do ta merrte vesh edhe Teuta tërë këtë që po ndodhë.

\* \* \*

Kështu, u lodha e u mërzita duke kërkuar nusen. Rashë nga shëndeti, më iku gjumi e oreksi. Pra kjo punë nuk qenkësh aq e kollajshme! Po le të bëhej ç'të bëhej! Do të prisja edhe një vit. Pa pastaj do t'ia filloja përsëri nga e para. Sapo e vendosa këtë gjë, rashë në qetësi. Dhe kur erdhi korriku, shkova në aksionin e rinisë. Atje, or tungjatjeta, gjeta edhe atë që kërkoja. «Larg paske shkuar!» — do të thoni ju. Jo, bre! Ajo ishte nga qyteti im. Ne qemë rritur bashkë dhe kishim lozur e qeshur. Edhe në aksion tok qëlluam. Apo nuk e kisha komisare!

— E, ee! Po kullot sytë, hë? Këtu ke të mbledhësh e të zgjedhësh... Apo, më fal! Ti nuk zgjedh njeri pa ta parë nëna! — më tha një ditë pa të keq. E kjo ishte Teuta e Refit Këpuçarit. Unë e mora

inat, po nuk kisha si t'ia shfaqja. Tërë kohën mbeti duke më brejtur si krimbi drunë! Kur largohej gjoja e mërzitur, unë ndieja një si boshllëk në gjoks dhe këmbët më shtynin ta gjeja. Për çudi, vura re se po ashtu bënte dhe ajo, por pa më rënë në sy.

«Ama, tani që ta kuptova hilënë, nuk ke nga më shkon, — thashë me mend. — Po, ku paskam qenë deri tani, de!» Njëqind plane në kokë po bëja si t'ia thosha. Kur, do ti! Një ditë, në vend që të afrohemishim më shumë, u zumë paq për një libër. Ajo u mërzit, se unë s'e paskësha kuptuar fare. Shkundi dorën dhe iku. Mua disi zuri të ma shponte kraharorin një si thikë. Shkova e gjeta.

— «Ata që zihen, duhen», — thotë një halla ime,  
 — i thashë émbël-émbël, me zë të ndryshuar krejt,  
 — ndaj mos u shqetëso! Dhe unë, po deshe të dish  
 ti, jam me hallën! — shtova duke u dredhur.

— Më nё fund, po shikon dhe afёr! — ma ktheu Teuta, duke u pёrmbajtur dhe vrapi e u fut e gё- zuar nё mes shoqeve.

ndar qifet o qit' i nukfis ette u ndar. I n e t duri  
njeri tonoci si nuk fumur. Dafurje qifet o qit' i nuk  
sob vloq. Si difitout se qit' qifet. Fumur, ian u  
oq qit' et aqim qifet. Nuk qifet si qit' qifet et qifet.  
Gebon hoxha qit' qifet et qifet. Lulen  
ben qit' et nuk fumur. Mysqut et qit' qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.  
Gebon hoxha qit' qifet. Nuk qifet et qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.

### S'DIHET QË NGA VJEN BEHARI!

Qit' qifet et qifet. Nuk qifet et qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.  
Tob tenu, tuzen qit' qifet. Nuk qifet et qifet.

Fshati i krushqve ishte afér me qytetin.

Ne do tē shkonim tek ata me rastin që xhaxhai  
im Sefedini kishte dhënë atje çupën. Tani ai ndodhej  
para një sikleti tē madh, se do tē vente pér herë tē  
parë te krushku.

— Më tē mençém dhe më tē gjezdisur nga ti, o  
xhaxha, nuk kemi këtu pérreth, — i thashë një mën-  
gjes. — Ndaj nuk ta ha dot qeni shkopin. Kot mera-  
kosesh se si do t'ia dalësh ndër krushq.

Ai tundi kokën dhe psherëtiu.

— Mirë e ke, or nipçe, mirë. Po ti harron se ne  
jemi majë mali e ata në derë tē kasabasë. Ku ua di  
zakonet atyre unë!

— Fundi i fundit, njerëz si ne janë, e pér gostë  
po shkon, jo pér asqerllék si qëmoti.

Xhaxhai prapë psherëtiu.



— E, or çun, e, — ma ktheu, — aq kupton e aq thua. Po kultura vjen si behari, nga fusha në mal. Pra kulturën e kanë më me bollëk ata. Druhem se mos gjendem ngushtë në mes tyre. Jam edhe në pletëri, dreqi e ngrëntë!

Pa pastaj e ndau mendjen të merrte me vete Shaban Gargullin, muhabetçjun më të madh të fshatit, e tok me të edhe mua. Kështu, një të shtunë u nisëm. Krushqit na priten me dorën në qafë.

«Më duket se mbarë filloj», mendova kur po hiqnim këpucët në korridor.

Xhaxha Sefedinin e vunë në krye të oxhakut. Fill pas tij i bënë vend Shaban Gargullit dhe mua. Përballë nesh qëndronte një plak i moçëm që nuk e hiqte llullën nga goja. Nën të vinin të tjerët, Xhaxha Sefedinit i shkëlqyen sytë, kur pa që ata ishin vendosur sipas sérës. Ai nisi të bluante me mend se me çfarë krushku huqli kishte të bënte. Fliste me qokë dhe nuk bënte shaka. Nga sytë e kuptova se në këtë lloj gostie nuk kisha çfarë t'i mësoja. Ai ishte hazër xhevap.

Bëra si bëra dhe iu afrova njërit prej palës së krushqve. Ai qenkësh mësues, me kravatë e kostum fringo. Xhaxhai më pa një herë si vëngër, se po lëvizja pa lejen e tij, kurse Hajdari, i zoti i shtëpisë, tha:

— E, e! Gjetët koka kokën?

Nuk vonoi dhe na shtruani rakinë. Me dolli e jo shaka. Si hodhi nja dy gota, xhaxha Sefedini më hodhi një vështrim të qeshur.

— Shiko punën me atë shokun ti, — më foli, — se unë jam si në shtëpinë time këtu. — Ndërkaq urimet vazhdonin. Unë me Selamiun bisedonim.

- Kur e mbaron shkollen? — më pyeti ai.  
— Në qershori, po ju sa vjet keni mësues?  
— Gjashtë, — m'u përgjigj dhe ngriti kokën t'i kthente urimin Shabanit, që i ishte drejtuar me gotë në dorë nga ana tjetër.

Nuk kishin rrjedhur as njëzet minutat, kur dëgjojmë të zotin e shtëpisë:

— Të gjeta një herë me plot, or komshi. Shëndetin e parë e pimë për krushkun Sefedin. Të dytin për zotin Shaban!, — po i fliste shokut që kishte në krah të majtë.

Mua më mbeti përgjysmë muhabeti me mësuesin, se heshtja që sundoi dukej sikur të thoshte: «Dëgjo dollinë dhe léri llafet». Kur të gjithë e rrokullisën shëndetin e Shabanit, m'u duk se xhaxhai u gjallërua si shumë.

— Ti kot iu fute këtij avazi, or krushk; ta kishim pirë më mirë me brump e sipas qejfit dhe jo me dollira! — iu kthyte ai Hajdarit. Unë e shikova i çuditur.

— Po ti, more, pse m'i zgap sytë? — m'u drejtua mua. — Nuk e di që dollive u vumë vizë ne në malësi!? Kurse këta këtu qenkan hala tek ura!

Hajdari bëri sikur nuk e dëgjoi.

— Ta shtyjmë ca kështu, hë, de, hë, sa të na bëhet buka! — tha duke marrë prapë gotën e rakisë në dorë.

— E paske qyfyrexhi xhaxhanë! — më pëshpërti mësuesi.

— Ashtu vërtet! Ai thotë se kultura vjen si behari, nga fusha në mal.

Mësuesi u bëri dredha fjalëve të mia.

— Gjyshi im bën dolli të gjata, — tha, — por ama

është i fortë dhe rri qiqër në të pirë. Me një qepë ka borxh të ngrysë kilen. Kurrë nuk është dehur dhe asnjëherë s'e ka larë qypin.

— Kurse ne kemi ndërruar zakon, — ia ktheva.  
— Bukë e raki bashkë i kemi.

Ai bëri sikur nuk dëgjoi.

— Na sillni ca bukë me këto mezetë, se ka si lezet, dreqi e mori! — thirri Shabani. I zoti i shtëpisë trokiti tri herë mashën në vatër. Sakaq në derë u dukën dy gra. Njëra nga ato ishte Sofia, e bija e xha Sefedinit. Ky nuk priti e tha:

— Ju gratë, mbaroni punë andej nga kuzhina dhe hajdeni në sofër, se ne të llafosemi me njerëzit e shtëpisë kemi ardhur e jo të fryjmë sytë me raki tërë natën!

Hajdari u bë oxhak i zi, po nuk foli. Vazhdoi doillinë. Dhe kur e mbylli, unë u lehtësova. Kisha frikë se mos pëlciste ndonjë sherr. Kush e mbante xhaxha Sefedinin pastaj! Të zotit të shtëpisë sec i shkrepitë në kokë. Shikoi njëherë përreth dhe u mat të ngrihej. Një i ri e ndihmoi duke e mbajtur për krahu. Ai doli jashtë e u kthyte pas ndonja dhjetë minutash. Xhaxhanë deri atë kohë e kishin shtyrë disa herë të ngrinte ndonjë gotë tjetër, por ai s'qe tundur. Kur u ul Hajdari prapë në qoshe dhe kur mori gotën përsëri, duke i uruar të gjithë me emër, unë kuptova se tërë ç'kishim pirë gjer atëherë paskëshin hyrë vetëm në dollinë e parë!

Xhaxhai u koll e tha:

— Ne nuk deshëm, po, meqë po na luteni shumë, do e ngremë dhe një dolli, por sipas huqeve tonë, ama! S'ke ç'i bën! Siç thoni ju është, «fshat e

zanat». — Unë, që ia dija huqet atij, e thitha se ç'donte të thoshte.

— Shaban, — vazhdoi, — merre gotën dhe të kam gjetur!

Ai nuk la njeri pa i ngritur shëndetin. Të gjithë dëgjonin me vëmendje fjalët e xhaxhait, pastaj kthenin gotën. Ishte dolli e mikut dhe nuk i thoshin shaka. Kur i kishin rrëkëllyer nga 30 gota, xhaxhai e pyeti Shabanin në kishin harruar ndonjë shëndet.

— Të themelit, më duket, nuk e kemi pirë, — ia ktheu ai.

— Po-o-o! Ja, ndaj duhet zëvendësdollibashi. Të themelit, — tha xhaxhai dhe e ngriti me fund. Ashtu bënë edhe të tjerët.

— Me okllai mbushe, o Tefe, se është dolli e mikut! — tha njëri andej si nga mesi i muhabetit.

— Unë do ta pi me gjithë qejf, po mban i tavannin të mos rrrotullohet që të mos më derdhet gota! — thirri ai që e quanin Tefe.

— Keni mushka apo kuaj? — pyeti me thumb xhaxhai. — Duan edhe ato shëndete, apo jo, o Shaban?

— Jo, një motor ka djali i mesëm i Hajdarit, që është mekanik në SMT, — u përgjigj një më i ri.

— Nuk ka qeder, nuk ka qeder! Ç'bëri mushka, ç'bëri motori! Një punë bëjnë. Shaban, të gjeta edhe një herë! Shëndeti i motorit! — tha xhaxha Sefedini dhe u palos nga ana tjetër. I zoti i shtëpisë pa me inat nga ai që kishte kallëzuar për motorin. Kështu e mbylli xhaxhai dollinë e miqve, me shëndetin e motorit të Eshrefit. Unë, të them të drejtën, u tremba ca, po pas një çerek ore u qetësova, se plaku bablok rrinte përsëri qiqër në sofër më miqtë. Mbante raki ai e jo shaka!

\* \* \*

Kur qejfi kishte vajtur mu në gju të kaposhit, xhaxhai po bëhej gati të kërkonte bukën. Po Haj-dari e mbushi prapë kaden deri në vezhdë me raki dhe e mori rishtas fjalën:

— Ta kuptova qëllimin, o krushk, ta kuptova... Më fal, se e kam humbur ca sonte, po aman, të ke-qen, mos ma vër veshin!... Miku ka të drejtë, o shokëni! Duhet dhe një dolli e tretë, po ne nuk u kujtuam në kohë. Unë po ia bëj një bromp Dapes, komshiut tonë. Hë, Dape, o burra, mos rri, po fillo dollinë! Nuk bën pa tri dolli tërë ky muhabet...

Kur e pa se tani të zotit të shtëpisë nuk ia kthe-nnte dot njeri mendjen, xhaxhai, si u mendua pak, e shikoi atë për një copë herë drejt në sy. Të dukej si-kur po i thoshte: «I varfri, më zuri rrota bishtin me ty!» Pastaj qeshi pak nën buzë, bëri me dorë të pu-shonin të tjerët dhe iu drejtua krushkut:

— Mirë thonë, ilakaja ngjan, pa bëhet. Mik si ti, me qiri të kërkoja, nuk gjeja. — U ngrit e nisi të përqafqohej me krushkun. Rakia ia kishte zgjidhur gjuhën.

Në filiim Dapja i shkretë kundërshtoi, dhe mua ma bëri qejfin, po pastaj u dorëzua e nuk po kujto-hej ta mbyllte!

— Vëri, ore, shpejt kapakun, se do të të mbetet si dollia e Sulos së Maliqit, që nuk e ka mbyllur ende as sot! — ia priti Shabani, po fjalët e tij nuk pinin ujë, përderisa në krye të oxhakut ishte xhaxhai. Dhe më në fund, kur sosi dollia, gjysma e burrave të krushqisë ishin shtrirë, kurse nga ana jonë asnjet. Pra, deri këtu ishim në rregull..

I erdhi dhe radha bukës. Ne kishim gjashtë orë që po hanim e pinim, po duhej bërë adeti. Sahanët filluan të vinin njëri pas tjetrit. Në fillim erdhën çorbat e jahnitë, pastaj byrekët e bakllavatë. Nuk vonoi shumë dhe në derë u duk një tepsi e madhe. Qe me koka të pjekura për merak. Secilit nga ne i plasën nga një përpara.

— Për të mira e më gjëzime, ore krushk! — tha xhaxhai. — Ne të erdhëm në shtëpi, ndaj bëj çfarë të duash. Por ama, po erdhe ti te ne, nuk ta bëjmë dot këshfu. Edhe sikur të na e arrinte krahu, do të bëheshim gazi i fshatit.

Pastaj m'u kthyte mua:

— Këta miqtë vërtet e paskan shtëpinë afër qytetit, po nga zakonet qenkan halá tek ura! Pas meje i foli mësuesit, Selamiut:

— Po ti, ç'punë bén, or bir?

— Mësim jap në shkollën 8-vjeçare.

— Aha! Të rruat zanati! Të dita pe thane, po dheti pe shtogu qenke, se sehir bëre.

E ndjeva se shokut nuk i erdhi mirë nga këto fjalë.

— Xhaxha e ke, mos të të vijë rëndë, — më tha, — mua kot po më ngacmon!

Kishin kaluar mbi dy vjet nga ajo darkë. Unë me xhaxhanë po shkonim prapë te krushqit. Këtë herë nuk e kishim me vete Shabanin. Para dy vjetve xhaxhai ishte i shqetësuar, kurse tani ecte kaluar, me kapelën mbi sy. Unë e ndiqja prapa si pulë e lagur. Mësuesi, sa na pa, zbriti nga bicikleta dhe na

takoi. Inati i kishte ikur. Ia shtrëngoi fort dorën xhaxhait dhe ia tundi dy a tri herë.

— E paski asfaltuar rrugën, hë? — e pyeta sa pér tē prishur heshtjen. Xhaxhai shikoi njéherë nga ne tē dy dhe pyeti:

— E kishe atéherë kur erdhëm ne këtë bicikletë, more mësues?

— E kisha, xhaxha, e kisha. Po pse më pyet? Apo tē vjen keq që nuk i ngrite një shëndet, si motorit tē Eshrefit? Në është kështu, ke rast sonte, e mbasse, duke i ngritur dollinë, më jeton më gjatë, — tha mësuesi duke qeshur.

— Pse, nuk i keni çuar në esfelt akoma ato tē flamosura dolli? — ia ktheu xhaxhai, duke u shkuar gishtat mustaqeve nga poshtë lart.

— Çfarë! — bëri sikur u habit mësuesi, duke më shkelur syrin fshehurazi. — Tani pa tri a katër dolli nuk del i gjallë nga konaku.

Xhaxhait iu vrenjt balli. U mbush me frymë dhe më bërtiti:

— Ngaji, or, këmbët, dhe mos më rri me këtë merhum prapanik! E mos m'i thirr më mësues! Nuk e shikon që mban në kokë qeleshen e fshatarit tē dikurshëm?

Tha kështu dhe nxitoi hapat. Unë i shkova pas dhe desha ta zbusja, por ai u zbras prapë:

— Ti mos u mërzit, — ma ktheu, — se unë e kam ndarë mendjen që, o do t'i shkund mirë sonte, o rashë e vdiqa.

Në atë çast na arriti mësuesi.

— Bëra shaka, — tha, — se dollitë na e kanë marrë tē keqen. Dhe unë s'jam aq i keq sa dukem. Atë

natë më dhe një mësim të mirë. Pra, nuk ndenja se-hirxhi.

Xhaxhai po e shikonte i habitur.

Mësuesi vazhdoi:

— Në fillim Hajdari na hodhi ca shqelma, po pastaj u shtrua.

— Po pse s'më the që në fillim, mor qerrata!? — ia priti xhaxha Sefedini i çelur.

— Shijojnë më mirë të ëmblat në fund, o xhaxha!

Xhaxhai e mbërtheu mësuesin nga zverku.

— Hë, kopuk, hë, kopuk! — i tha duke buzëqe-shur. — Pse s'thua që do bëkemi qejf sonte?

Pastaj u fut në mes tonë, na kapi nga krahu dhe eci me fiap më të vendosur.


## UNE, PËRGJEGJESİ I BLEGTORISË-PENDAR!

— Mos e merrni me kaq tërsëllëm, të shkretën!  
Jemi njerëz dhe njeriu ka namuz, pa ka edhe gjak.  
Ku i dihet! Ja, u nxeh gjaku, pastaj e dini çfarë  
ndodh? Lesheli bëhet....

Kur e pashë se u mallëngjyen, vazhdova më tu-  
tje. Unë flisja e secili mendohej për hesap të vet.  
Kjo mbledhje më ngjalli kujtimet e asaj kohe, kur  
sapo më kishin emëruar përgjegjës blektorie.



Prill qe, më duket. Në ditë të hallit ishte katan-  
disur gjëja e gjallë që mora në dorëzim. Mishi m'u  
rrëqeth, kur e pashë. I vura punës gjoksin tim qo-



sheli dhe çdo gjë nisi të rrrokullisej për së mbari. Pa filloj qumështi të rridhte si lumë, edhe i lopëve, edhe i dhenve, edhe i dhive. Derrat mezi sa i nxinte lëkura nga të shëndoshët. Bile, edhe pulat, sikur të më kishin pritur mua, filluan të tejkalojnë për herë të parë prodhimin e vezëve. «I fortë paske qenë!» do të thoni ju. E po keni edhe një çikë hak, veçse gjyshi im, ndjesë pastë, ka qenë blegtori më i mirë i nahijes. Dy qengja i lindte delja, treqind ditë e milte lopën, cjeptë si gomarë i bënte. Kur isha kalamë, më thoshte se soja bëhet nga goja. Ndaj unë ia shtija varda ushqimin gjësë së gjallë. Dhe më doli vërtet fjala e të ndjerit gjysh. Apo nuk më bëhej qejfi kur më lëvdonin! Më rritej qimja e bëhesha, si të të them... Pa, kur më nxorën një herë në gazetë, të më shikoje si ndrija! Nami im tanë po i kalonte kufijtë e kooperativës. Po nuk thonë kot: «Të ardhët nga mos e pandehsh!» Dhe mua, papritur, nga s'e pandehja më erdhi. Që të mos e zgjas, po ju tregoj se si u bënë sebep qetë e punës. Mos kujtoni se u rroka me ata dhe kësisoj e humba betejën! Se, asnijëherë nuk më ka shkuar ndër mend të rrökem me qe. Pse, e ha atë kokërr ulliri unë?! Po, ke parë ti! Ata të uruar më katandisën nga goxha burrë, përgjegjës blegtorie, në pendar. Dhe unë, sikur të ma hiqte engjëlli, qetë e punës nuk i kam pasur qejf që në krye të herës. Isha razi të mbaja në pëllëmbë të dorës vetëm atë gjë të gjallë që jepte prodhim. U mbushja grazhdin kurdo që u tekej. Kurse qeve? Ç't'u shtije atyre, or t'u bëfsha! Bile, më dukej se kot i mbanim. Të ishin lopë e po hajde, de! Edhe mulliri do bluan te me qumësht. Ndërsa ata... Për të mijelë jo, për të qethur jo, vezë s'jepnin, as mjaltë. Atëherë, ç't'i domin!? Për të punuar tokën? Po tërë ata traktorë çfarë

do bënин pastaj? Me këtë mendje në kokë, isha munduar të bindja kryetarin, bile edhe kryesinë, që për ushqimin e këtyre «bandillëve» të kujdesej çdo brigadë, me qëllim që të qëroheshin nga listat e mia njëherë e mirë. Kështu rrođhi viti i parë. Çdo gjë mbeti si në mjegull. Pa erdhë e të plasi një sherr, që s'e merrte vesh qeni të zotin.

— I takojnë brigadës së arave?

— Jo!

— I takojnë asaj të blektorisë, se edhe qetë gjë e gjallë janë! — ia prisnin të tjerë. Më në fund m'i përplasën mua. «I shkreti unë, — thashë me vete, — këta ma mbyllën derën fare.»

Dhashë e mora duke vrarë mendjen dhe më në fund m'u duk se ia gjeta rrugëzgjidhjen edhe kësaj bezdie që më kishte kapur.

«Duhet dredhur edhe këtu nga pak, se drejt-përsëdrejti as derri i egër nuk ia del», më vetëtju një ditë në kokë. Kësosoj, kritikat që më bënин për qetë i prisja mirë se, në fund të fundit, nuk ka vdekur njeri prej qeve. Megjithatë, nuk e vija edhe aq ujin në zjarr për ata. Më ndihmonte edhe diçka tjetër. Kisha vërejtur se qetë e punës na kishin një zakon të mirë. Po të mos u shtije të hanin, nuk pëllisnin. Ndryshe ishin lopët. Po t'i lije pa ngrënë, ato të ngrinin nga gjumi mu në mes të natës. Pale derrat dhe pulat! Sa për qetë, nuk mund të qahesh. Ata nuk e kishin këtë huq barbar. Kur e mora në dorëzim detyrën, u betova në heshtje: «Ama ratë në dorën time? Jua rregulloj unë, që ç'ke me të! Oj, doni t'ia hidhni kësaj bote me 15-20 ditë-pune që bëni në vit!»

— Qetë na duhen dhe për transport me qerre e slita, o Kasoo! — më tha një ditë kryetari i kooperat-

tivës, tamam sikur ta kishte kuptuar mendimin tim.

— Me ato rrugë që kemi ne, po nuk u fut «ZIS-i», nuk futet as qerrja! — ia ktheva me plot gojën. Ai perëndoi një herë sytë, ndërsa vështrimin e nguli nga mali përkarshi. Pastaj, me një zë që m'u duk se i doli nga hundët, ma priti:

— Mirë e ke, or Kasem Qerimi, mirë, sipas mendjes sate, po nuk u fut në fshat treni, nuk futet as makina, apo jo?

Nuk e kuptova se ku ma pati atë fjalë kryetari, ndaj shtrydha rradaken ta gjeja. Pas pak ai u nis në drejtëm të arave të malit dhe unë mbeta i pasqaruar. Me qetë e punës vazhdoja avazin e vjetër.

— «Ua thave zorrët me atë bykun e grurit. Po shtjeru edhe ndonjë njomishte të uruarve, o Kaso! — më tha pas ca ditësh zootekniku, kur e kishte pikasur se pér kashtën unë nuk isha i kursyer.

— Do e kem parasysh, o xhan, do e kem, — i thashë dhe këmbët, pér çudi, prapë nga kavaletat e kashtës më quan. Dhe syrin e kisha të hapur, xhanëm, se zootekniku, Fetiu, ishte i përvëluar pér qumështin e leshin. Kur vinte puna pér qetë, ai e bënte një sy qorr e një vesh shurdh. Unë po aq doja. Pa erdhën e u katandisën qetë si mos më keq. Duke sheshin si ca zgërdalla, ku dallohej fare mirë peshku i kurrrizit e ku numëroheshin brinjët. Po edhe këmbët mezi i ndërronin, kur ecnin. Kurse brirët s'u kishin pësuar gjë. Behari donte kohë të vinte. Moti nuk po mbante si e pëlqeja unë.

«Po të bjerë dhe një borë, qetë do të na e lënë shëndenë», — dëgjoja ndonjë zë. Ke parë që më zuri dhe mua frika. «Po sikur, larg qoftë, të fillojnë të ngordhin vërtet? Si do të vejë filli im pastaj?»

Kujtoja zooteknikun dhe veterinerin dhe ndieja një farë lehtësimi. Se, në fund të fundit, çdo gjë ka radhë. Pas tyre binte përgjegjësia mbi mua. Ata i kisha si ombrella, or vëlla. Këtë unë e kisha pruvuar edhe më parë, kur kishte ngordhur ndonjë delle a dhi. Gjendej një diagnozë dhe ne shpëtonim përmrekulli. Vetëm një sëmundje na e pati shpuar xhepin njëherë, një farë «kasheksi». Bagëtitë që kishin ngordhur nga kjo na mbetën neve, se shqip kjo don te të thoshte «dobësi» që kishte ardhur nga kujdesi i paktë. Kur e sillja në mend këtë, mishi më rrëqet thej. Dhe ëndrrat e këqija më ngrinin havandan. Çfarë bëja ditën me qetë, më shpifeshin natën. Njëherë m'u bë sikur ata më kishin vënë në mes të një sheshi dhe mundoheshin të më vrisnin. Në dorë m'u ndodhën një sfurk i gjatë i stallës dhe një copë beze e kuqe. U mundova ta hidhja bezen po, për dreq, ajo më ndiqte ngado që shkoja. Pas saj qetë vinin si të tërbuar. Brirët dhe qimet u vetëtinin. «Çudi! — thosha me vete. — Këtyre u paskan ardhur këmbët birinxhi! Kur u shëndoshën kaq shpejt?!» U mbrojta me mundim një copë herë. Pastaj një ka i madh i qerres, që i thërrisnim Surrok, nuk e hëngri gënjeshtren time. Ai më ra drejtpërdrejt dhe më vuri me shpatulla në sheshin me bar. Atëherë unë bërtita sa munda që të më dëgjonte ndonjë stallier për të më ndihmuar. U zgjova i trembur nga zëri i sime shoqjeje, Hamidesë.

— Ngrehu, ore derëzi, se po të kërkojnë ata të kontrollit kooperativist! — po më thërriste ajo, duke më hequr jorganin. Nuk e zgjata. Fërkova sytë mirë e mirë dhe u kënaqa që kisha qenë në ënderr. Pas-

taj, si u ngrita, dola jashtë ashtu si keq e keq, me sy tē fryrë.

— Hajde, Kasem, hajde! — më foli njëri prej tyre.

— Jemi tē autorizuar tē kontrollojmë gjendjen e qeve tē punës, — shtoi më i riu e më i paduruar. Më therën mu në lug tē zemrës ato fjalë. Me xhaketën në dorë dhe flokët tē pakrehur, u nisa nga ata.

— Mirë, — u thashë pas ca, — zëmë nga stalla<sup>+</sup> e brigadës së gjashtë!

E dija që atje kisha qe pér tē qenë.

— Jo, jo! Unë kam mendimin ta zëmë nga brigada e qendrës! — tha njëri nga ata.

«Po, or vëlla, po, nuk ke faj ti. Edhe, unë, tē isha në vendin tënd, që andej do e zija», fola me vete. Kjo ishte çfarë ishte! Punët me gjénë e gjallë që jepte prodhim shkonin sahat fare, kurse këta shkojnë dhe kontrollojnë qetë e punës! Jo, moj e keqë, jo, ç'më gjeti! Çfarë i kam bërë kësaj bote, xhanëm? Pastaj unë e di se nuk tē zënë gjynahet! Eh! Ishte kontroll kooperativist se, po tē ishin zootekniku apo veterineri, ua gjeja kollaj ilaçin. Ata vërtet në filim e kishin nisur me vrull, po tanë ecnin në punën e tyre avash-avash.

Pyetjet filluan me rrebesch:

— Sa qe ke? Ku e ke remontin pér aksh brigadë? Na jep dokumentet e vitit tē shkuar! Ku e ke bilancin e ushqimeve?... «U pa puna, — belbëzova.

— Si e kanë zënë, pér tri ditë mbarojnë». Pér çdo përgjigje mbanin shënimë. Ku gjendej përgjigje pér tërë ato, or vëlla! Unë nuk kujtoja dot sa vjeç ishte Gastarja, lopa rekordmene e kooperativës, e jo më moshën e çdo kau! Më duket se deri sot e pata. Mo-

ri tē krisur puna dhe mua do tē mē marrē lumi», thashë me vete. Përgjigjet, sa vinte, po mē veniteshin fare. Kur nisëm, isha ezber, po tan, éhë! Rashë nga vakti: «Si urdhëron, ashtu éshëtë.» «Po, keni tē drejtë». Nuk e dija kështu. «S'na e kanë thënë specialistët», flisja si papagal. Me këto mendova se do ta kaloja lumë urtë e butë, po hë-hë! Nuk qenë nga ai lloj ata. I kisha bërë gabim llogaritë. Ç'kishin shkruar nga ç'u kisha thënë unë fillim e mbarim, i kënduan në mbledhjen e zgjeruar tē kryesisë, pa lënë një majë gjilpërë, or shokëni!

Mbajta goxha fjalë para tyre, për t'i mallëngjyer e për t'i bérë më tē logjikshëm. Dhe m'u dûk se po i arrija qëllimit, po i bëja për vete, por jo. Shikova njëherë përreth. Të tërë më shikonin si me tallje. Asnjë nuk më buzëqeshte si më parë. Për çudi, pas pak më erdhi dhoma vërdallë. E treta vështrimin në një pikë, tek bashkoheshin dy faqet e murit afër tavanit. Po qfarë tē shihja! Një ka tamam si Suraku i qerres nuk po m'i ndante sytë. Hajde e thuaj, tē lutem, se nuk dalin éndrrat! Pra, po e pësoja për shkak tē qeve! Kësaj, or xhan, i thoshin tē tē humbiste jahnia për një qepë!

Kryetari i kooperativës éshëtë një që, shko deri tek ai dhe ktheu. M'u bë se aq paskësh pritur. Sa më dënuan, mua e më bënë pendar, fill e në brigadë më nisi.

— T'i japim pendën më tē mirë Kasemit! — tha brigadier Veloja, kur më pa se vajta atje. Nuk arrita ta thithja pse po e bënин këtë. Më vonë mora

vesh se penda që më dhanë paskësh qenë më e mira e të këqijave. Ditën e parë a i bëra a nuk i bëra katër orë punë, se aty nga dreka penda ime mbeti fare. Të tjerat kishin mbetur më parë, ndaj shokët i kishin lëshuar t'i kullotnin hergjele në mezhda.

Jepi, o Kasem, jepi! I thonë prill dhe kemi përpara rrumbullak shtatë orë ditë! Kanë fuqi qetë e tu, punojnë goxha, se i kë ushqyer mirë, — u tall njëri me mua.

— Mos e ngitni drëqin, mos e ngitni, sellas ne të qeruar nuk jemi! Kujtohem i t'i ushqejmë ditën që i zémë në pàrmendë, — ia priti një tjetër.

Ai druri që hëngra në mbledhjen ku ma kënduan, nuk që gjë ndaj atij që po më jepnin në brigadë. Njëri më hidhte tjetri më priste. Dhashë e dhashë me ata majë më majë, po nuk ia dola mbanë. Kur u urtësova, e ulë kokën, nuk më ngacmuani më. Po unë mbeta që mbeta pa ditë punë atë pranverë. Kur e pashë se u dogja, i vura kapak më timen ta ndryshoja mendjen përqetë e punës. Kot nuk thoshin: «Të zëntë buka e kaut!» Dhe mua ajo më kishte zënë. Pas rrebesheve që hoqa, erdha e u kthjellova. Bëra be t'i mbaja imire qetë. Paçka se nuk do të më jepnin as bulmet as lesh. Këtë vendim e mbajta sekret, nuk ia thashë njeriu, se aq donin pastaj të tjerët. Pra, rashë në brazdë, sic më këshilluan ata të kontrollit kooperativist, megjithëse ca si më vonësë.

Kur e provoke është kurrisin tënd, veke mend ti, qerrata! — tha kryetari kur më pa një mëngjes herët duke kullotur qetë. Nuk iu përgjigja, por i zgjata kutinë e duhanit dhe e ndjeva së isha i lehtësuar, — qëllim i kësaj gjësia është që s'ka gjithë




## BERA NJË SKALDABANJE!

E po, ashtu nuk i dilej. Çdo punë në shtëpi gruaja e bënte. Laj, fshi, spërndrit dhomat, shkund çdo ditë, qëndis perde e rrugica e më the të thashë. Pra, vendosa të bëja dhe unë diçka. Çfarë, do pyesni ju. Një skaldabanjë si atë të Çelo Çalokut.

«Ai nuk është më i zoti se unë!» thashë, kur po mendoja për skaldabanjën. Fap, u ngrita nga minderi dhe menjëherë ia nisa. I pari që e pësoi ishte tubi i bakrit me diametër 8 mm. Dha e mori gruaja të më bindte se atë e paskësh lënë në shtëpi shofer Sadedini, çuni i hallës së saj e se do ta merrte pas dy ditësh, po nuk i eci.

«Një në dorë» — numërova me vete dhe i hoqa vizë në kapakun e paketës «Ardian» zërit numër 1, që emërtohej «tub bakri diametër 8 mm., i gjatë 2.5 m». Tani vura re se i kishte ardhur radha tubit të çelikut me diametër 100 mm. dhe pastaj atij me 90 mm.



Janë si afër me njëri-tjetrin ndaj, kur të kërkoj njërin, do mundohem të zhvati edhe tjetrin, vendosa. Punën e nisa si mbarë, po nuk e vazhdova dot ashtu. Në magazinën e Drejtorisë së Ujérave më zunë sytë ca tuba nga lloji që kërkoja, po magazinieri hidhej këtu e binte atje tej.

— Ata nuk t'i jap, sikur kaq ta bësh dhëm-bin! — më tha, se së bashku me saracineskën do t'i vendosnin në një rezervuar, që kishte ndërtuar me forcat e veta kooperativa bujqësore e Hithrasit. Si papritur, një ditë gjeta një copë tub me diametër 1-100 mm., sa pér kokën e furnellës. Kështu unë lashë zërin numër 2 dhe numër 3 në kapakun e paketës dhe kalova në zërin 4. Me një çikë të tërhequr, ua mora atyre të Ndërmarrjes së Grumbullimit. Brodha nënja tri a katër oficina pér ta shpuar, po asgjekundi nuk më ndezi. Njëri më përgjigjej se ishte i mbytur deri në fyt, tjetri bënte fresk duke tundur këmishën pas trupit, e duke u mbushur me frymë, kurse i treti më drejtonte nga oficina e Ndërmarrjes Komunale, ku kryheshin punë personale.

«E di, ore xhan, e di se nga bie ajo oficinë, po nuk më vjen zëri, se desha ta bëj ashtu si më kollaj», ia ktheja me vete, duke ikur me tërë rragnet në dorë. Sa arrita te Komunalja, e para gjë që më zunë sytë, ishin tubat kryesorë. Kërcëva përpjetë nga gëzimi. Si këmbyem nga një shtrëngim duarsh me Sharen, teknikun e oficinës, e pas shë me vend të futesha në temë.

— Dua të anavas një skaldabanjë, po...  
— Po nuk ke tubat, he? — më ndihmoi Sharja. Qeshi njëherë mirë e mirë pak si nën buzë, ma bëri me sy dhe vazhdoi:

T'i gjej unë ata, e mos u merakos hiç! — Të mos e zgjat! Ia shkarkova Shares ç'kisha me vete dhe e lamë të piqeshim me iniciativën time nga ora 18 në klubin kryesor të qytetit se, helbete, mund të shkëmbenim më të qetë ndonjë muhabet pune e gjuetie! Mbeta dakord që skaldabanjën ta bëja plotësisht atje, se nustai nuk e kishte të parën. Hapalnjë ditë më vonë portofolin, gjeta në të kapakun e paketës «Ardian» dhe u shkova një kryq fund e krye shënimëve që kisha mbajtur.

— Do e bëj dhe unë një gjë të rëndësishme këtë muaj! — rraha gjoksin para sime shoqejë! — Të mirë dhe të lirë! Ke përtë parë! — Ma thuaj, pér kokën tënde, çfarë ke nisur të bësh? — m'u lut ajo. Po unë nuk tundeshin Kisha vendosur që ta mbaja sekret dhe kur ta çoja të prisja, përgëzimet e saj. Më në fund erdhi edhe ditë pér ta marrë tek usta Sharja. Aty nga ora 11 arrita në oficinë. Doemos që më priti mirë. Pasi këmbyem disafjalë, ai nxori një fletë porosie dhe, mbasi i futi një tre karbona nën të, e mbushi. — E gëzofsh skaldabanjën! — më uroi. Ndër-kohë dorave itij shkroi shifrën 145 lekë, të shoqëruar edhe me shkrim. Desha ta pyesa njëherë, po ishte vonë. Ai më ngjiti në dorë fletën e sapofirmosur. Si e pashë kështu, u përtypa mirë e mirë, politërë rrugët të nxirrin në një qafë! «Paguaj paratë dhe léri dënglat!» Zérati kishte vënë një pér një, qerratai! Gjékundi nuk kishte lajhitur Ore edhe energjinë elektrike, edhe shpimin e vrimave nuk kishte lënë pa vënë! Veten nuk e bëra, po shkova e pagqvë menjëherë. Pas një gjysmë orë, me skaldabanjën në karrocën e Komunales, shko-


ja drejt shtëpisë. Rrugës po rikujoja të gjitha sa më ndodhën. Kisha menduar ta bëja nja 50 lekë me forcat e mia, por... Kur sosa në shtëpi, për fat nuk e gjeta gruan. U futa ta provoja mallin që mezi e kisha bërë. Pas pak ajo u nxeh mirë. Hapa tërë gëzim rubinetin e dushit. Prita të dilte uji, po më parë ai i uruar doli nga currili, pa vajtur ende në dash. E mbylla tërë inat dhe nisa ta shikoja me sy të çapëlyer. Në atë kohë ndjeva zhurmë në korridor.

— E gëzofsh skaldabanjën! — dëgjova urimin e komshies. Po çuditesha se ku dreqin e kishte marrë vesh ajo, që unë kisha blerë skaldabanjë.

— Dil nga banja, o Laze, se do ta provojmë një çikë këtë! — thirri tërë gëzim ime shoqe. U zura keq. Kur qeshë futur nuk më kishte parë njeri. Si dreqin e paskësh marrë vesh tërë lagjja! Për dreq, ajo edhe rriddhë, pa le! Kur po bëhesha gati të hâpjë derën me duart që po më dri-dheshin, u têrroqa pas dhe e fsheha atë mall aq më kimet. Pastaj dola. Po çfarë të shihja!? Gruaja me gjithë komshien kishin sjellë një goxha skaldabanjë, prodhim të Gjirokastrës! I hodha një sy si vëngër dhe e lashë vrarin prapë në banjë. E fsheha edhe më mirë atë që bëra te Sharja, Lëré seç vajti! Ajo kishte qenë skaldabanjë, që sulli gruaja, e jo ajo e Shares! Kur mora vesh se ime shoqe e kishte blerë 90 lekë, sa nuk u têrbova.

## T'I BIEM DREJT!

T'i biem drejt; punën në kooperativë nuk e pëlqeja fort. S'më hiqej nga mendja natë e ditë që të bëhesha punëtor në ndërmarrjen e shfrytëzimit të pyjeve. «Atje bëhet jetë, or vëlla! — thosha me vete, — pa në kooperativë, ta marrin shpirtin fushatat. Në dimër pastaj fillon lagështia...» Me këto mend në kokë, desh ika e vajta atje ku ju thashë, po, për drëq, kur u bëra hazër t'ia lë shëndetin fshatit tim, u ngatërrova me Nafen. Pastaj, ku të linte ajo! Na erdhi edhe Dikja brigadier dhe unë e lashë batall të ikurit. Sa mori brigadën ai, filloi të na i mblidhte rripat. Donte punë, jo llafe. Por, më pas u zbut e u bë qengj. S'na kërkonte hesap fare. Kështu që nuk e pati të gjatë. Shpejt ia dorëzoi detyrën Verës. Ç'ia dorëzoi! I dhanë lugën. Mua më erdhi keq. Por edhe



and I wanted to tell him about my new  
job. All I could say was "I'm sorry."

Halimit, se për ne të dy Dikja ishte për t'u pirë në kupë. Vendet më të mira të punës na zgjidhëte. Dhe në, ama, krah i djathtë i ishim bërë. Sa herë na i pati shkruar ditët pa marrë në dorëzim punën, aq të mira qofshin! Kur thanë të vihet Vera brigadiere, na dogji, ç'është e vërteta. Ajo ishte razi të mos i falte babait të saj diçka, jo neve, që... ç'na kishët, në fund të fundit! Javën e parë bëra si bëra me brigadiere Verën. Kurrizi dhe eshtrat më thernin nga lodhja, por e mbaja veten si burrat.

— Jepini, jepini! — na thoshin shokët mua e Halimit, — se deri tanë jeni fshehur qosheve! — Dhe qeshnin.

\* \* \*

Bëja, ç'bëja dhe mendja se pse më fluturonte prapë në ndërmarrjen e shfrytëzimit të pyjeve. Kur nuk ika në fillim!... «Ah, Nafe, Nafe, çfarë më bëre! Më qafë më paç!» thosha me vetë. Kur, do ti të më ngjallen shpresat për të shkuar ku kisha ëndërruar prej vitesh! Ia thashë këto kryerat të këshillit popullor të fshatit.

— Po mirë, — ma ktheu ai. — Ne e kemi në plan të dërgojmë një në atë ndërmarrje. Meqë dashke ti, shko!

Por, kur u diskutua kjo gjë në brigadën time, xha Tafili tha:

— Ka për të rënë në tre qe Sefja atje, po hajt!

Kështu më lejuan të shkoja e të bëhesha punëtor. U' gëzova shumë. Prita mbërëmjen, të takoja Nafen.

— Je bëre gazi i botës! — m'u lëshua ajo. — Ta dish që, po shkove me gjithë mend, me mua nuk ke gjë, se ti kërkon të shkosh që t'i shpëtosh punës!

Tha kështu dhe u zhduk.

«Ja, edhe kjo m'u desh!» thashë me vete.

Brigadieri dha një normist që poqa të parët, më caktuan punëtor trupash, se më panë goxha kolos. Ditën e parë nuk do ta harroj kurri. Trupat e mëdhenj prej ahu në ato të tatëpjëta si thikë nuk më bindeshin fare. Në tokën e lagun këmbët nuk më mbanin gjékundi.

— Mbaje bme kujdes capinën, se ta zë trupi poshtë! Manovro sipas terrenit, mor çun, se nuk je në fushë këtu! — më therriste Batushi.

Atë ditë e ndjeva veten më të lodhur se kurri. Në brigadën e Verës qenqësha qarë kot! Këtu ishte ç'ishte! Apo nuk të kritikonin! Hajde babam, hajdel! Një ditë, pse ranë dy trupa poshtë nivelit të sharrës, desh u bë nami!... Si kaloi një javë, e ndjeva se nuk e ngrysja döt atje. Puna punë dhe dajaku dajak! Tjetër prisja e tjetër gjeta. «Të keqen e brigadës në kooperativë!» — mërmërita. Të ikja? Të bija prapë në dorë të Verës? Jo, mor, çfarë! nga dita e dhjetë brigadieri, si me marifet më pyeti në kisha kafshë samari në shtëpi.

— Na duhet tē shfrytëzojmë degët dhe majat e pishave pér dru zjarri, — më tha, — dhe t'i nxjerrim në xhade. Po tē deshi qejfi, merr kälë a mūshkë, c'ke, dhe fillo puno! Që atë natë shkova në shtëpi. Babai u bind dhe ma dha kalin. Tani në kantier unë bëja dru dhe i transportoja me kälë. Puna m'u lehtësua shumë.

— E, more Sefe, na le ne dhe fillove me drutë tani, hë? — më tha një herë njëri nga shokët e trupave. — Unë s'i ktheva përgjigje. Por gjithnjë, kur ndieja trupat tē binin poshtë me zhurmë, futja kalin në gëmushë dhe i zija zilen sa tē kalonin punëtorët. Pastaj vazhdoja. Para syve më dilte dita kur do tē kthehesha nga ndërmarrja në fshat. Kisha dasmën pérpara dhe Nafja, e «zbutur», me siguri do tē më priste me mall. Një ditë, si morëm rrrogat. Batushi më thirri në tavolinën ku ishtetur në klubin e kantierit. Duke pirë kafe e cigare, më shikoi mua drejt në sy dhe më tha;

— Pse u shmangesh punëve tē rënda ti? Je dhe goxha djalë! Erdhe gjer aty sa i more kalin dhe tyt eti, pa le!

Ai fliste i qetë dhe ngadalë, kurse unë nuk dija c'përgjigje t'i jepja.

— Mirë se rrini, xha Batush, — u dëgjuar një zë mbi kokat tona. Ishte Islami, punëtori i ngarkim-shkarkimit. Nuk e zgjati, po i tha Batushit pér mua:

— Ky qenka një rafinak i madh!  
E pashë me vend tē ikja sa më parë nga ata.  
Po dal t'i shtitë një dorë tagji kalit! — u thashë, dhe bëra tutje nga dera.

\* \* \*

Nuk di në ju ka rastisur që para se të bësh një punë të jesh i gëzuar në kulm, po tamam në atë kohë të del një tjetër që të zemëron sa s'ka ku të vejë. Ashtu më ndodhi dhe mua atë ditë. Isha përgatitur të shkoja i gëzuar në fshat, po pas bisedës në klub nuk më hynin më në sy as vajtja në shtëpi, as paratë që kisha nxjerrë.

— Ne nuk kemi nevojë pér të hollat e tua, se sa kemi pér ty! — më tha babai.

— Me punë i kam marrë, — ia prita unë. Ai uli njëherë sytë, thithi cigaren dhe pastaj vazhdoi:

— Me punën e kalit, ama. Vendin që të takon e ke lënë bosh në kooperativë,

Më bllokoi krejt. Nuk kisha nga t'ia mbaja.

— Prit, mor burrë, të çmallemi njëherë, se u bë kaq kohë që s'e kemi parë cunini! Pastaj gjykoje dhe ti, të shkretën! tha ime émë duke u lutur.

— Nuk i bëhet vonë fort, këtij, jo! — ia ktheu ai.

Atë natë rashë të flija herët, por gjumi nuk kujtohej të vinte. Më dukej sikur kisha nxehësi, më bëhej, sikur më pickonin, pleshtat. Vonë, shumë vonë i mbylla sytë. Nëpér gjumë turli, éndrrash shikoja.

«Kéta këtu janë tre qetë e xha Tafilit, — më thoshte Dikja. — Në do, të mos mbahesh në gojë nga njerëzia, urdhëro e futu në mes tre qeve, si Halimi! Kur u zgjova, e ndjeva veten të lodhur. E pashë se duhej kthyer në brigadën e Vërës. Të tëra i bëja hallall, po veç romuzet e shokëve në sy të Nafes, kush i priste!

**VÈREJTJE ME SHËNEM NË... PORTOFOL**

12. Jan. 1908. — At the time of my return from the  
affair I had no idea what was to happen, but

Pashë ç'pashë, u ngrita ta merrja edhe unë fjalën. Nuk më rröhëj më! Duhej mbrojtur i shkreti Harun. E telendisën mu në mës të mbledhjes. Dhe përse, pa? Se na u prish një kv. domate, u nxorën jashtëpërdorimit tre kv. tranguj e na u drunjëzuan pesë dynymë bamje, se, démek, i la pa vjelë! Sa të ngushtë që jemi ngå shpirti! Harruan këta, xhanëm, se Haruni është bëre copë përf ne!? Po kush na i nxirrte nevë shalqinjtë e pjekur, sa vinim në përimore!? Po kush na e zgjedhët neve, ore, bostanin të verdhë dyllë! Haruni. Tani ja, si po ia shpërblejmë!

«I ká kalbúr perimet me qëndrimin e tij të pakujdeshëm. » — thoshte aktkontrolli. Pse, ore, të hash bukë dhe të mos bësh thërrime? Kalben, o, pos! Ku ka, kalben, se ku nuk ka, çfarë do të kalbet, apo ëpingat? Punë e madhe se u drunjëzuan pesë dynymë me bamje! Edhe po të mos



ishin drunjëuar, kush do t'i përdorte në fshat ato? Te ne vetëm Shabanica, që është bijë babe nga kazaja e Korçës, gatuan gjellë me bamje... «Për këtë kemi mëndimin që të zhëmtohet arka e kooperativës me 580 lekë!» — përfundonte akt-kontrolli i grupit të kontrollit kooperativist. E po, ky është kulmi, or vëlla! Pse, tërë ato para do të paguajë i shkreti Harun? Po është burrë me kalamaq ai, ore! A mendoni për të ju, apo jo?

Gjithë ai Harun, erdhi e u struk në një qoshe dhe u bë sa një grusht. E dërrmuani qyqarin. Unë prita e prita që ta mbronte njeri, po jo, or ti, se nuk që e thënë. Kur të merr për keq nganjëherë, hap dërën, se nuk është gjë më. Nga llafet nuk na prishej terezia, xhanëm, as mua e as Harunit, se na që argasur lëkura. Qortimet i kishim «plesht në vesh». Po amë, vërejtje me shkrim në... portofol nuk kishim parë. Një nga të rejat e propozoi këtë djall vërejtje. Kjo nuk shkonte fare.

«Perimet prishen në arë dhe ti të derdhë paratë në arkë! Jo, jo, jo! Kjo nuk durohet, — tha-shë më vete. — Sot kjo lloj vërejtjeje zuri Harunin, po kush më siguron se nesër nuk më zë mua? Ndaj, o vëlla, mbrojë tani, që të të mbrojë ai pastaj!» Këto më shtynë të ngrihesha e të merrja fjalën.

— Unë mendoj se shoku Harun ka bërë gabim të madh. Me këtë ai tregon se ka nënveftësuar perimet, të cilat kanë vitamina, e ku ta di unë tjetër çë. Por, meqënëse e ka kuptuar gabimin, unë mendoj të mos i japim vërejtje me shënim në... portofol, por në biografi. Nuk e shihni, xhanëm, se sa e ka kuptuar, i varfri, gabimin?! — përfundova dhe u ula. Në këto raste pak e saktë duhet folur.

Në zyrën e kryetarit, ku bëhej mbledhja, ra heshtja.

«Sa më shumë të zgjatet kjo heshtje, aq më mirë është përmua, se rrinë e bluajnë cilën rrugë të zgjedhin. Ja, si lëvizin në karrige! Më duket ua ndërrova mendjen! Ishallah e falin edhe kësaj here Harunin!» po thosha me vete. Kur u ngrit kryetari i kooperativës.

— Janë dy mendime, — tha. — Grupi i kontrollit, kooperativist mendon që Haruni të zhđemt, jo arkën e kooperativës, kurse Lazja mendon t'ia falim. E si do të vendosim?

Shemshedini, që u ngrit i pari pas tij, e përkrahur mendimin tim.

«Do ta fitoj davanë, më duket», thashë prapë me vete. Por, pa u ulur mirë Shemshoja, u ngrit Jeshileja. Mua më theri në zemër.

«Ajo, është pjesëtare e grupit të kontrollit, kooperativist dhe do na djallosoë, të dy!» mendova, aty për aty.

— Dhe unë jam dakord që Haruni të mos paguajë, — tha ajo.

«Të keqen e gojës, po ti ku je, moj zogëzë, se po e thyen akullin!» i fola me sy i kënaqur, se e kuptova që edhe në grupin e kontrollit kooperativist e paskësha një përfaqësuese timen. Po ajo, si mori një herë frymë mirë e mirë, vazhdoi:

... — Meqë u ardhka keq Lazës dhe Shemshedinit, le të paguajnë ata për Harunin!

«Oho! ç'më polli belaja!» mërmërita. Atë çast të tjerët u ngritën dhe përkrahën mendimin e Jeshilesë.

«Pse, xhymertë me mallin e kooperativës do të bëhem ne, a?» — dëgjoja zëra.

«È hëngre, Laze! Ç'tu desh kjo dasmë në Karbunarë, a i zi!» qortova veten në heshtje.

— Dakord kështu?

Ishte kryetari që pyeste:

— Cfarë dakord, ore! — fola unë. — Ai që ka  
dëmtuar, le të zhëdëmtojë! Nuk nxori mësim një-  
herë ky Haruni! Jo, or, jo! Le të paguajë 580-lekë-  
shin dhe me gjithë rrabat bile, po deshi grupi i  
kontrollit kooperativist! Ku ka kështu, mor jalu!?  
Pse, liberalë jemi ne? Sot, dëmtove? zhëdëmto!  
Rrugë të mesme s'ka!


Kaq thashë unë dhe u ula. M'u duk se i shkarkova drutë e mia dhe nuk kisha pse të rrija më në këmbë.

— Tani që të erdhi në derën tënde, e dimë se je i sqaruar mirë, o Laze. Po ama, një herë të mundi qyqja dhe të pamë se cili je! — tha xha Tafili.

Se ku ma pati, nuk e mora vesh, por di që atë ditë për një qime shpëtova nga një vërejtje me shënim në... portofol.

## KUJDES NGA «ARINJTE»

Në fshat lajmi ishte përhapur me një shpejtësi të pabesueshme. Një ari i madh, s'dihet nga ç'pyll erdhi, i mërzitur (nuk dihet nga se), një ditë kaloi lumen e Devollit dhe u fut në krahinën e Sulovës. Nuk mbahej mend denbabaden që ndonjë ari të kishte kaluar në Sulovë ndaj të gjithë ky lajm i la pa mend. «Ari në anët tonë!» ngri-nin supet pleqtë e fshatit. Kjo nuk kishte bërë vaki ndonjëherë. Mirépo, me gjithë habinë e pleqve, sipas fjalëve të njerëzisë, ariu po bënte kërdinë. U fol në fillim se në një kooperativë paskësh ngrënë për një natë 7 zgjoje bletësh. Pa pastaj e kishin pësuar lopa e Kamberit dhe ca bagëti të tjerë. Dhe çudia vazhdontë. Mbasi i ungnj me mish ariu, sipas të thënave, na paska filluar të hajë edhe zarzavate, si domate, spaca, patate, bile dhe kastravëca. Sa vinte dhë. «Bëmat» e ariut po rri-



shaka se kur thoshtetë vërtetën, u kishte thënë plèqve të fshatit se një ditë më shi, te Qafakë Pluhurit, i kishtë parë gjurmët e ariut në baltë. Dhe pati nga ata që nga këto tregime të çuditshme filluan të frikësöheshin. Kur s'vinte fjala përitë ruajtur arat me misër në mal, lloje lloje arsyeshedilnin. Njëri thoshtë se trembej të dilte natën, diçkush se kishte gruan pa qejf e ku ndi unë!

Kryetarit të kooperativës i polli belaja. Në fillim të gjithë e kishin marrë me shaka çështjen e ariut, por tanimuk mbante më ujë orizi. Ai i thirri në kryesi të rinj nga brigada e Nexhipit. Mendoi në fillim t'u thoshtë larg e larg punën, por pëstaj hoqi dorël Uartët troqësuar.

— Jeni caktuar të bëni rojë në arat me misër në mal. Atjeka dëmtimë. Ju duhet të ndihmoni për të mbrojtur bukën e popullit!

Të rintë dëgjoni të përqendruar kryetarin, i cili për një çast mendoi se edhe kati druhëshin nga arriu vindaj shtoitur mësimi. Po që se shik —

— Do ju pajisim edhe me armë. Po qe se shik koni ari në misër, qëllojeni! Autorizimin e kemi marrë.

— Mos u shqetëso, o kryetar! — foli njëri nga të rintë. — Ne nuk kemi hallin e ariut. Jo një, por edhe dhjetë të vijnë, ua bëjmë dermanin. — Dhe me të errur, u nisën në drejtim të arave të malit, për të ruajtur misrin.

Dy külakët e fshatit, Selfo Dhëmbaku e Harez Grykasi, kishin një copë herë që ia kishin

shtruuar me raki. Fytyrat e skuqura, gjuha e trashur, jakët e shkopsitura si dhe dy shishet gati të zbrazura në dorë, tregonin se ata kishin ardhur në qejf.

— Më plaqin sytë e mos paça njeri, ja me këtai veshë e dëgjova kryetarin t'i tho-thoshte brigadier Në-Ne-Nexhipit përpunën e alaaariut, — tha Selfoja, duke copëtuar me dhëmbët e mëdhenj si kalë një kofshë zogëze.

— «Pse nuk i ruam njeri arat në mal, o Nexhip?» — ishte kequr brigadierit. Dhe ai pastaj...

— Mirë, o, mirë! Ti, Selfo, e ke zakon, të shkretën, që i zbuluron gjérat...

— Mos paça njeri, të them! Dëgjo Selfoni! Të gjithëvet u ka hyrë frikë në palcë. Ti, ore vëlla, ke mendje femër, se bukur e mendove atë purnën e ariut.

— Ha-ha-ha! Hajde gëzuar! Tjetri zgjati gotën përpara...

— Këtë punë që nisëm duhet ta vazhdojmë, o Selfo!

— Çfarë të bëjmë?

Selfos i ngriu në fytyrë një buzëqeshje e lehtë.

— Sonte është errët, rojë nuk ka. Të vemë të marrim nja dy kafshë misër! Shiu është në të filluar, gjurmë nuk do të n'a mbeten e atyre përsëri do t'u shkojë mendja tek ariu.

Tjetri kishte ulur kokën mbi pjatën me mish dhe bënte sikur nuk e dëgjonte. Ndenji një copë herë ashtu, e pastaj tha:

— Jo, se na zënë dhe e paguajmë, këg, o Hariz vëllai!

Tytë paska hyrë lepuri në bark! Dëgjomë mua! Ky rast duhet shfrytëzuar. Merr vesh, apo jo? Nuk kemi si të hakmerremi ndryshtëndaj tyre, po harrove ç'kemi hequr e ç'po heqim?

— Mirë, xhanëm, mirë, po si shumë misër po marrim. Çfarë ta bëjmë, or Hariz? — tha Selfoja me zë pak si më të ulët.

— Bagëtitë, ore, le ta hanë! Vec t'u shkaktojmë zararë! Asnjë nuk e kishte marrë me mend se puna e ariut do të na dilte kaq e mbarë.

— E po, mirë, ore Hariz, mirë! — u bind Selfoja dhe, duke ngritur gotën me raki, uroi shokun:

— Hajde, brump, dhe gëzuar!  
— Gëzuar!  
— Harizi e ktheu me një frymë.  
— Tani unë po iki, — tha. — Në orën 12 po vij me nja dy thasë te gropat me dushqe...

Pesë të rintjtë, pasi arritën në mal, u ndanë në dy grupe nëpër arat e mbjella me misër dhe rrëgulluan vendin për të kaluar natën. Agimi me Safetin përgatitën ashtu keq e keq një kanik, sa për t'u mbrojtur nga shiu, që pritej të fillonte nga minuta në minutë. Zjarr nuk ndezën, se ashtu që në udhëzuar. Nuk kishte kaluar ende ora, kur dëgjuan gugatjen monotone të një shpendi nate. Pas pak u dëgjuat qartë zhurma që bën misri kur thyhet. Dy të rintjtë e përqendruan vëmendjen andej nga dëgjonin zhurmë.

— Të jetë ariu, Safet? — pyeti Agimi shokun nën zë.

— Nuk le di, — u përgjigj tjetri ngadalë. Pastaj bëri gati pushkën dhe tha:

— Ke parë ndonjëherë ari ti, Agim?

— Jo, Safet.

Zhurma sa vinte, shtohej. Pas pak, në fillim të turbullt, pastaj më të qartë, dalluan hijen e një... njeriu. Kur ishte afruar rrëth njëzet metra, hija mori poshtë një lugine, ku misri ishte më i dendur, dhe vazhdoi ta këpuste dhe ta dëmtonte.

— Ndal! Duart lart! — thirrën gati në një kohë dy të rintjtë.

... Në mëngjes, pa lindur dielli, shtatë vetë po zbrisnin nga arat e malit. Të rintjtë kishin vënë përpara Selfon dhe Harizin. Të dy kishin nga një thes të mbushur dinka me misër në kurriz. Në atë kohë Nexhipi pohndante planin e punës në qendër të brigadës. Kur panë dy vjedhësit me misër në krahë, të gjithë u habitën.

— A-aa! Këta qenkan dy arinj dhe jo një, siç qe hapur fjala! — tha Anifeja, që njihej në tërë brigadën për shakatë e saj të holla.

— Tani do t'u dalë frika edhe atyre burrave tanë, se na vdiqën me atë të shkretë ari! — shtoi ajo duke qeshur.

— Hajdeni, arintjtë e xhaxhait, hajdeni! — foli një plak me qesëndi.


— Ujqër, skile e çakej ishit, këtë e dinim. Po ju paskësh bimbetur merakutë, bëheshit dhe arinj! Sido që ta ndërroni lëkurën, prapë në çarkun tonë do të bini! — tha xha Bektashi dhe u tundi para syve stadin prej thane që mbante në dorë.

## **MBRETI «FAL TAKSAT»**

Ato ditë vere të vitit 1933 në fshatrat e nën-prefekturës së Gramshit, përvëç vapës përvëluese dhe thatësirës së madhe që kishte plakosur, u bë-në ferrë edhe taksidarët. Se, nuk të fâlte qeveria. Doje të mbaje gjë të gjallë? Ta paguaje taksën të tërë dhe në kohë. Pa kishte taksë edhe pér tokën, pér urat, e më the e të thashë. Nuk mbaheshin mend dot të gjitha. Gramshioti, që nuk prodhonte as gjashtë muaj bukë, taksat kishte mangët, që të mos e ngrinte kokën kurrë!

Derdhu koha e derdhu, kur na del fjala se qenqëshin mbledhur disa burra pér t'i bërë një kërkesë qeverisë që t'ua falte ca taksa, se ishin popull fukara. Me së t'i paguanin!?

— Ishallah e bëjnë vërtet, se jemi katandisur pér ibret! — thanë një takém fshatarë nga Bërsniku kur morën vesh lajmin.



— Edhe po nuk e përfillën kërkesën, ç'hum-bëm! — ia pritën të tjerët.

— Po cili do ta shkruajë kërkesën, se? Ne në fshat nuk këmi asnjë njeri të kënduar! — folën prapë ata të părët.

— E shkruan Hamza Kopaçja. Ai është edhe deputet i Zogut, — ua ktheu beu i Kodovjatit, që i kishte ngritur veshët, kur dëgjoi muhabete që lidheshin me qeverinë.

— Jo, jo, t'ia lëmë Rremë Selimit këtë punë, se ai ka haber mirë në këso meselerash! — iu përgjigj beut njëri nga fshatarët. Beu i Kodovjatit e shikoi me inat, dhe përdrodi buzët me mospërfillje. Pastaj vazhdoi:

— Ai qafir, do e paguajë ndonjë ditë, siç e ka zënë. Atje shkruajini letrat ju, atje, se do t'ju nxjerrë në selamet ai!

Një ditë prej ditësh, disa fshatarë i shkuani vërtet Rremës në shtëpinë e tij në Bulçar. Si e mori vesh përsë kishin vajtur, ai buzëqeshi pak, pshëretiuj njëherë thellë dhe tha:

— Mirë, mirë, unë jua kuptoj hallin dhe do t'jua bëj kërkesën, por shpresë nuk kam të pijë ujë. S'është qeveri pér ne kjo.

Pastaj u ul të shkruante. Herë shikonte fshatarët që prisnin me ankth të mbaronte lutjen, dhe herë kujtonte kohën kur kishte qenë deputet në kohën e Fan Nolit e pastaj si e kishte përjashtuar Ahmet Zogu, se demek nuk e cte sipas avazit të qeverisë. Si mbaroi, iu drejtua fshatarëve të tij:

— Do t'i pjellë mendja ndonjë yrnek tjetër atij maskarai, mbretit; nuk rrон dot ai pa zhvatur popullin, jo.

Lutjen e firmosën në shumë fshatra dhe, më

në fund, e nisën drejt e në Tiranë. Pritën njerëzia disa muaj, po përgjigjja e saj nuk po dukej gjë-kundi.

— Punët e mira bëhen ngadalë-ngadalë, — përgjigjej nënprefekti, kur e pyesnin për fatin e letrës.

— Lartmadhëria e tij atë e ka marrë, por do-kohë që t'ju përgjigjet, se ai më parë ka hallin e politikës, pa pastaj merret me kërkesat tuaja! — thoshte me një të qeshur tallëse.

Një ditë u përhap lajmi me shpejtësi të madhe, se gjoja përgjigjja e letrës paskësh mbërritur në nënprefekturë me postën e ditës së xhuma se mbreti paskësh falur taksat. Nënprefekti me komandantin e xhandarmërisë së nënprefekturës, zotni Xhelal Xhahilin, bënë një listë të gjatë me emrat e kryepleqve të fshatrave dhe të disa të moshuarve, që do të thirreshin në mbledhjen që do të organizohej për leximin e përgjigjes. Kur erdhi radha e fshatit Bulçar, nënprefekti tha:

— Përveç kryeplakut, të thérresim edhe Rremë Selimin!

Komandanti i xhandarmërisë së nënprefekturës mori qëndrim gatitu, pastaj ferkoi mustaqet e tij të verdha dyllë dhe ia ktheu:

— Ç'e do këtu atë helaq, më qafsh! Ai është kundërshtar i tërbuar i lartmadhërisë! Nuk ka lënë gjë pa thënë për Zogun tonë të Parë. Sidomos tani që është ndaluar pirja e duhanit me çibukë, çfarë nuk po dërdëllis lart e poshtë! Unë ta them hapur, po e zura gafil ndonjë ditë, do t'ia bëj kurrizin më të butë se barkun.

— Mirë, or, mirë, — e ndërpree tjetri, — mjaft shkumëzove! Vetëm dajakun di ti, o derëbardhë,

kurse nga politika je tapë. Po mori pjesë Rrema në mbledhje, ne i themi shqip: «Ja, çfarë bën qeveria për popullin fukara, or tutkun, dhe jo ashtu siç përrallis ti! Ndaj mbledhje rrakaken!»

Mbasi u mendua pak, komandanti tha:

— Thirre, or, thirre, po ke për të parë, po nuk ta djallosi mbledhjen! Eshtë jetit e kaluar jetit ai!

Kur mori haberim për mbledhje nga pojaku i fshatit, Rremës turlisoj mendjesh i vinin. Për kokën e tij Zogu paguante. Ai, bile, kishte paguar disa herë, po nuk ia kishte dalë mbanë. «Dhe tanj do ta kenë një qëllim, maskarenjtë», mendonte Rrema. «Më mirë eshtë të shkoj dhe të mos ma bëjë syri tërr. Burri një vdekje ka hak!» Tha kështu dhe bëri tutje të shalonte kalin. Mbas disa orësh udhëtimi, arriti në nënprefekturë. Përparrë ndërtesës ishin mbledhur shumë vetë. Të gjithë prisnin me ankth të merrnin vesh c'gjë e madhe kishte ndodhur. Ishallah njoftohej se qenë qëruar njëherë e mirë të gjitha taksat!

Nënprefekti dhe komandanti i xhandomërisë ishin veshur si për bajramllék.

Mbasi u pëershëndet me të gjithë, Rrema u ul pranë shokëve.

Si e pa që nuk mungonte pjeri, nënprefekti doli rëndë-rëndë në krye të shkalleve të ndërtesës. Fshiu mustaqet, nxori barkun e madh përparrë, tundi njëherë dorën sig bënte në dolli të tretë, dhe me sy gjysmë të mbyllur bërtiti:

— Lartmadhëria e tij dhe qeveria, kërkesën e fshatarëve të nënprefekturës së Gramshit e morën parasysh. Për këtë ju kemi thirrur sot në këtë mëxhelis. Tani do ju këndoje zojni Xhelali vendimin,

që erdhi përpara një javë këtu. Hapni veshët mirë dhe ua thoni të gjithë fshatarëve tuaj!

Pastaj ai u koll dhe u ul përsëri në vend:

— Hë, ore, këndoje, çfarë pret!? — iu shkreh Xhelalit. Ky u përmend, u ngrit nga vendi dhe filloi leximin. Një qetësi e madhe ra në cast në tërë njerëzit e mbledhur.

«... Duke filluar nga data e sotme, fshatarëve të nënprefekturnës së Gramshit u hiqen taksat si më poshtë...»

Këtu Xhelali mori frymë thellë, fshiu ballin me shami dhe vazhdói:

«... Hiqet taksa për çdo kokë gomari...»

— Urra, rrroftë naltmadlinia! — u dëgjuan disa zëra.

— Prisni, ore të uruar, prisni, se nuk e kam mbaruar së kënduari të gjithë! — tha Xhelali dhe goditi me kërbaç trapezën që kishte përpara, për të vëndosur qetësinë. Dhe kur kjo u vendos, kumboi përsëri zëri i tij i ngjirur nga rakia që pati pire në darkë.

«... Taksa e gomarit i kalon dhisë...»

— Urra! — u dëgjuau vëtëm një zë. Ishte kryeplaku i Tunjës, që nuk i kursonte të brohoriturat, qysh kur komandanti i postës së xhandarmërisë e pati goditur një herë në kokë me një opingë. Që atëherë ai i shkreti ishte shurdhuar nga njëri vesh.

— Ua a a! — ia bënë të tjerët. — Çfarë falje eshtë kjo?! Fukarait i qenka hequr taksa për gomarin dhe i qenka rrásur për dhinë!

Kurse një plak me takije tha:

— Siç ma pret kaplloqja, taksat qenkan shtuar!

— Pusho, more teveqel; se, për emër të zotit,

të jap një kërbaç të mirë që të vijë qylafi vërdallë! Kérkesë pér falje takse bëtë, ja dhe ajo u pranua! Ç'doni më tanil? — iu kanos zotni komandananti i xhandarmërisë së nénprefekturës. — Dru doni?

— Mirë e ke, o komandar, se dhija na ha pyllin. E donte, atë taksë ajo, kurse gomari i shkretë vetëmegjembha, ndaj ia hoqën. Po deshi dhia t'i hiqet taksa, le të hajë gjemba dhe meseleja zgjidhet, — tha kryeplaku i Sojnikut.

Nga bisedat që po vazhdonin pa radhë, — ukrijua një rrëmujë që nuk e merrte vesh i pari të dytin. Xhelali mbeti më këmbë, se nuk kishte kënduar ende dy rreshtat e fundit.

— Po ti, o Rremë, cfarë mendimi ke pér këtë falje? — e pyeti kryeplaku i Strorit. Të gjithë puschuan dhe kthyen kokën nga Rremë Selimi. Ky ungrit, shikoi njëherë pérreth dhe, si u bind se po e dëgjonin, u përgjigji:

— Qeveria dhe mbreti, që i pacim lart e mbi krye, janë shumë të zgjuar e zemërgjerë dhe ia qajnë hallin fukarait.

Nénprefekti, tek e dëgjoi, i bëri veshët pipëz edhe një herë më shumë dhe pohoi më kokë.

— Dëgjoni, dëgjoni! — tha ai. — Dëgjoni zotni Rremën, se është burrë më një barrë mend, dhe jo si ju, fjasko fare!

Në të vërtetë asnjë zhurmë nuk kishte, por nénprefektit i erdhë mirë që Rremë Selimi po ndrejtë me Zogun. Si tha këto, ai iu krekos komandanit të xhandarmërisë dhe u duk sikur deshi t'i thoshte: «E, ore karamanjoll! Vetëm dajakun di tis! E shikon se ç'bën politika?» Ndërkohë, Reema u ul e duke u ulur vazhdoi:

— Kaq kisha pér tē thëhë.

— Nënprefekti ngriu në këmbë i hutuar.

— Amä, c'niā çudite edhe ti, Rremë! — i thanë Elsa me një tón gáti kërcënues.

— Po pse çuditeni, or shokë?! — u pëshpëriti Rremë. — Të zgjuar jañë sá s'ka, si mbreti si qeveria é tij. Dhë nuk kishte si tē ndodhë ndryshe. Gomarët duhej t'uá hiçnën takshen gomarëve.

— Ah, po. Kështu thuaj, — folën tē kënaqut ata që e kërcënuar.

Pas këtyre fjalëve që pëshpëriti Rremë, nisi një zhurmë e madhe dhe tē qeshurat nuk kishin tē pushuar.

— Ejani tē ikim tani me lezet, — tha një i moshuar nga Grazhdani dhë i dhë dorën Rremës tē pàrit. Pas tij u ngrit edhe Rremë e shkuan tē dy atje ku kishin lénë kuajt.

Pa kaluar pesë minuta tē gjithë qenë larguar. Mbetën vetëm nënprefekti dhë komandanti i xhandomerisë, Xhelal Xhahili, me përgjigjen e mbretit në dorë, ku i kishin mbetur edhe dy-tri radhë pa i lexuar.

Xhelali i hodhi vështrimin nënprefektit dhë e pyeti me atë vështrim:

— Si u bë kështu?!

Nënprefekti ngriti supet pér t'i thënë:

— As vëtë nuk e di si u bë!

Pastaj Xhelali i foli me zë:

— Unë s'marr vesh nga pulatika; zoti nënprefekt, se mta kërbagin më ka dhënë lartmadheria e tij, mbreti Zogu i Pafë, dhe kërbagin di tē përfdor. Po edhe pulatika jottë nuk ná nxori gjë në krye!

## **HAJDUTËT VIZITOJNË USTANË**

Major Aliosha Llazarjevit i polli belaja. Nuk kishte as dy muaj që u gradua, por puna nuk i shkonte mbârë. Kishte një javë që nuk bënte gjumë. Sapo fillonte punën, i tekej për të ikur, por sa dilte përqashta pendohej. Nisej për në shkollën e mesme të qytetit te djali dhe përfundonte në klubin Riga. Si e zbuste hallin e madh që e kishte zënë me nja tri dopio vodkë, fluturonte me «Volgën» e tij jashtë qytetit. Ia kishin prishur qetësinë e një grup hajdutësh, që nuk kishin lënë makinë pa zhveshur në qytet. Madje, makinës së kolonepa lit të milicisë flitej se i kishin marrë... motorin! Tani që kishin futur duart në makinat e milicisë, Llazarjevi e ndiente se ky grup i kishte ditët të numëruarë, mëgjithatë po e mundontë si shumë. Shqetësimin e major Llazarjevit e kishte pikasur edhe Nina, gruaja e tij e dashur. Një ditë ajo i tha:



— Vitjan e vendosëm në shkollë të zgjedhur. Ti, i dashur, je gjithnjë me pünë të mirë. Për bukuri jemi. Nuk ka ku të vejë. Plaçkë boll. Ç'arsye ke të jesh i mërzitur?!

Lazarjevi thithi cigaren thellë dhe foli duke psherëtirë:

— Kam keq sa të zbuloj dhe këtë grup, xhanëm! Sa do të kënaqej koloneli! Ai, me siguri, do t'i flasë mirë zëvendësministrit për mua dhe pastaj... prit transferimin!

Mbasi u qetësua pak, e shoqja vezhdoi:

— Kaq të rrezikshëm qenkan këta vjedhës, i dashur?

Lazarjevi u mbush me fryshtë dhe u përgjigj si nën zë:

— Shumë, shumë, e dashur, sa ti nuk mund ta mendosh. Po, nejse! Ta lëmë këtë muhabet! Sot, meqë është e shtunë, them të shëtisim me makinë jashtë qytetit, se të dy jemi shumë të lodhur.

Si mori miratimin ledhatues të së shoqes; u nis me «Volgën» pér në punë. Atje mezi sa priti të mbaronte orari zyrtar. Dyllosi dosjet, kasafortat dhe derën, pastaj doli nga ndërtesa katërkatëshe dhe u drejtua pér te «Volga» e tij. Po, ç'të shikon-te! Makina nuk ishte atje. Vrau mendjen edhe një herë se mos e kishte lënë në vend tjetër, por jo. Iu drejtua rojës. Ai iu përgjigj në çast:

— Ju vetë e morët aty nga ora 11-të, shoku major! Çuditem se si keni hyrë prapë dhe nuk ju paskam parë!

— Bthu, idiot! — shfryu majori. — Do ta shikojmë këtë punë, — ulériu. Dhe u drejtua nga stacioni i takstive të qytetit. Njëherë mendoi të jepte alarmin, por dhe kjo nuk i zgjidhte gjë. Ashtu bëri dhe koloneli, kur i kishin vjedhur motorin e «ZIM-it», por hajdutët nuk po dukeshin gjékundi. «Mos u ndje! — i tha vetes, — se nuk dihet ku i del krisma kësaj punë!»

Kur vajti në shtëpi, e qetësoi Ninën se gjoja makinën e kishte dërguar për t'i ndrequr një defekt që kishte pësuar paradite. Pasdrekë dolën shëtitjë më këmbë. Ai fliste me të shoqen, po mendjen nuk e kishte aty: Ku do të ishte vallë makinë e tij tan? Çfarë ngjyre i kishin dhënë dhë me çfarë targe e përdornin?

Java që erdhi nuk solli asgjë të re. Makina e zhdukur nuk po jepte asnje shenjë. Priti më kot t'i hidhte ndonjërit nga shokët apo eprorët qoftë edhe një fjalë, por jo. Kush bëhej merak se një majori i kishin vjedhur makinën! Kështu, si pa u lidjerë, erdhë prapë e shtuna. Pa mbaruar mirë orari zyrtar telefonoi Nina.

— Aljosha, Vitja nuk vjen edhe këtë radhë, i dëshur. Më tha në telefon se është mirë, po do ca fuqia. Mundohu të na sigurosh biletat për nesër në atë ansamblin amerikan!

Si la dorezën e telefonit në vend, majori kroi kokën:

«He, é, é! Nuk i bëhet vonë njeriu se sa punë kë! — mërmëriti. — Ca më tëpër gruas. Ajo do qejfin e saj.»

Pas pak doli në fund të shkallëve. I hodhi edhe një herë sytë ashtu kot te vendi ku linte makinën dhe nuk u zuri besë. Tamam «Volga» e tij ishtë tek kishte qenë gjithmonë, në vendin e zakonshëm. Nuk kishtë ndryshuar as ngjyrë e as targë. Aljosha dëshi të pyeste rojën, por nuk guxoi. Prëku nën xhaketë pistoletën dhë u sigurua se e kishte aty. Pastaj, si me druatje, po i afrohej makinës. Brënda nuk dukej asnje njeri. Dëra ishte e kyçur. Ai é hoqi dhe pa sé çdo gjë ndodhej në vendin e vet. I ra në sy se nië sedilien e shëferit

zbardhët një žarf pak si i fryrë. I mësuar nga përvuja e profesionit, e shikoi me një farë dyshimi dhë, si i erdhi pak trötull, vëndosi ta merrte. Mbi zärf që shkruar me gërmë kapitale: «**NË DORE, MAJOR LLAZARJEVIT.**». Mësia u mendua pak, shikoi njëherë përrëth. Kur u sigurua se nuk e shih-të kush, e hapi. Brenda ishin një tufë tollona benzoli, disa rubla dhë një letër. Ja se çfarë shkruhej në të:

*Shoku major! Na fal, nà fal, njëqind herë na fal! E morëm makinën tuaj gabimisht, se pandehëm mos ishte jona. Tani që u bindëm se qenka juaja, po ju kthejmë. Po ju lëmë benzolin, si edhe pagën që ju përket për përdorimin e makinës një javë rrësht. Në shenjë mirënjohjeje po ju dhurojmë edhe dy biletat për të parë shfaqjen e ansamblit amerikan që jepet nesërmbrëma.*

Duke ju kërkuar ndjesë, ju falënderojmë!

*Shokë, që nuk do ti njihni kurri.*

Llazarjevi e shikoi rishtas letrën. U çudit shumë nga gjithçka lexoi. Eksperiencën e punës nuk e kishte kushedi se çfarë, megjithatë ndodhira të tillë s'kishte dëgjuar të kishin ndodhur më kollegë të tij. Pö kjo? Ti merrnin makinën, të bridi-më më të gjithandëj dhë t'ia kthénin prapë! Ç'ti thoshe kësaj!? Shikoi sahatin e kilometrazhit. Ai tregonte së ishii bëre 1275 km. të tjerë, qysh së ia kishin rrëmbyer befas. «Mirë paskan écür,» mëndoi majori më buzë më gaz e nöfulla të shtrënguarë, duke e drejtuar makinën për te vilë e tij më shpejtësi.

Atë të shtunë ai ia plotësoi të gjitha tekat Nënës. Dolën shëtitje me makinë jashtë qytetit, qeshën e kënduan, e prapëseprapë mendjen nuk e hiqte dot nga hajdutët. Ah! Sa afër kishte qenë me ta! Po, ç'e do! Nuk pati fat t'i shtinte në dorë! Si u clodhën mirë e mirë, u kthyen në vilë të kënaqur. Nina, kur mori vesh se biletat për të parë ansamblin amerikan ndodheshin në xhepin e të shoqit, iu hodh në qafë e gëzuar. Edhe ditën e diel paraditja kaloi gëzueshëm. Mbasit hëngrën drekë, dolën nga vila me makinë. Aljoshës njëherë i shkoi në mend të njoftonte që ta mbërthenin grupin e hajdutëve, të cilin e kishin aq afér por, kur u kujtua se në atë mënyrë lavdia do t'i kalonte tjetërkujt, u tërroq. E la në vend të sigurt makinën dhe iu afrua tok me Ninën teatrit. Sytë e majorit lëviznin me kujdes. Ai përpiquej të kapte çdo lëvizje të dyshimtë, po nuk arrinte. Ia ngjiti syrin një të riu të gjatë tre rrështa, më poshtë, por pas pak e pa atë duke cicëruar me çupën e gjeneralit.

«Jo, ky nuk është ai që më duhet», tha duke u fundosur në ndenjësen e tij të butë. Edhe më vonë sytë e majorit kërkuan me kujdes, por nuk pikasën asnjë person të dyshimtë përreth.

Kur mbaroi shfaqja, ata shkuan në restorantin kryesor për të ngrënë darkë. Pastaj, të lumtur e si të dehur nga dita që kaluan, u kthyen në vilë. Kur u futën në oborr, Lazarjevi u nis ta konte makinën në garazh, kurse Nina u ngjit nëpër shkallë. Papritur u dëgjua klithma e saj. Majori iu gjend pranë me një frymë, po çfarë të shikonte! Nënës i kishte rënë të fikët. Dyert ishin të gjitha hapur, ndërsa dhomat – të boshatisura. Kishte mbetur

vetëm stufa, dollapi i kuzhinës i lëvizur nga vendi, se pas tij kishin nxjerrë frigoriferin. Në njëren nga karriget gjeti një letër. Posa e pa, me syrin e tij të stërvitur, e njohu menjëherë shkrimin. Iшин по ата «миq», që i kishin lënë zarfin në makinë. Atje i thoshin:

*Ti paske qenë guak i madh, Lazarjev! Neve nuk na pëlqeu makina jote e pariparuar, ndaj ta kthyem. Me plaçkat që të gjetëm në shtëpi, epo, mbetëm disi të kënaqur. Pse, si kujtovë?! Vetë do t'i mbaje tërë ato, që ke vjedhur më keq se ne? Mos u mundo të na kërkosh, se nuk na gjen dot.*

*Përshëndetje hajdutshe!*

*Nga një grup shokësh, që dëshirojnë të mbeten miq me kokën tënde boshe.*

Lazarjevi ndezi një cigare dhe e mbajti veten si burrat. Kur u qetësua e shoqja, ata filluan të ngushëllonin njëri-tjetrin.

— Mos u bëj merak, e dashur! Plaçka vihet prapë, — i tha ai Ninës, e cila po freskohej në çezmën e kuzhinës.

— Ke shumë të drejtë, Aljosha im, — ia ktheu ajo. — Ka edhe më keq. Mua ndaj më ra të fikët. Pa kujto atë shfaqjen e filmit amerikan, që u dha mbrëmë në televizor! Hajdutët e lanë pa kokë të zotin e shtëpisë. Të Paktën ne e kemi kokën.

## PASQYRA E LËNDËS

RRENJE TË FORTA .....	3
NË FSHAT PËR «PUSHIME» .....	10
«ME MEND NË KOKË, XHAN I VELLAIT!» .....	18
SI IA LASHË SHËNDENË PAZARIT .....	29
KUR ISHA BEQAR .....	39
S'DEHET QË NGA VJEN BEHARI! .....	49
UNE, PËRGJEGJES I BLEGTORISE-PENDAR! .....	60
BËRA NJË SKALDABANJE! .....	69
TI BIEM DREJT! .....	74
VËREJTJE ME SHËNIM NË... PORTOFOL .....	80
KUJDËS NGA «ARINJË» .....	85
MBRETI «FAL TAKSAT» .....	91
HAJDUTËT VIZITOJNË USTANË .....	99

Fejzo, Sh.

Vërejtje me shënim në ...  
portofol. Tregime humoristike.  
T., «Naim Frashëri», 1979.

... f.

B-ka të mëdha dhe  
B-ka të vogla: 891. 982-32  
F. 39.

---

Tirazhi 6.000 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK – Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1979.